



## LISTA E KANDIDATEVE TE PS DHE LSI

# PS TREGON FORCE, RAMA DHE RUÇI NE MESIN E LISTAVE

Zbardhen emrat e kandidatëve për deputetë të dy partive të mëdha të mazhorancës. Kryeministri i 6-ti në Vlorë, Ruçi i 9-ti në Fier. Surprizat, kush ikën e kush vjen në listat e PS dhe LSI



“

## RAMA LE JASHE 28 DEPUTETE AKTUALE, HABIT LARGIMI I ARTA DADES

Ministrja Milena Harito rrezikon, në dyshime Spartak Braho, shpërblehen Spiropali dhe Hyseni



## “JAM GATI T’I JAP PD-së GJITHÇKA QE I OFRUAN NEGOCIATORET E PPE”

Rama ka deklaruar se s’pranon vetëm shtyrjen e zgjedhjeve, por ka vendosur si kusht vetingun

► FAQE 2-5



### LISTA E LIBRA-S

## Ben Blushi dhe Mimoza në Tiranë, ja kandidatët e tjerë

► F8



### LISTA E PLOTE E PDIU

## Idrizi dhe Doda në Tiranë, ish demokrati Fatos Hoxha në Kukës

► F8

### SKADON AFATI

## PARTIA DEMOKRATIKE JASHE ZGJEDHJEVE, JA 20 PASOJAT KATASTROFIKE

Bojkoti, PD humbet zërin në Parlament, prezencën mediatike, selinë e partisë, komisionerët zgjedhorë, pagat dhe ndikimin mbi drejtësinë e re

► FAQE 7



### SUPLEMENTI “RILINDASI”

## PSE KUTELI, MJESHTRI I RREFIMIT MBETET ENDE I PAZBULUAR

Si u zhdukën veprat e shkrimtarit Mitrush Kuteli. Më 4 maj shënohet 50 vjetori i vdekjes së shkrimtarit

NGA BEHAR GJOKA

► FAQE 13-21



## SI U KRIJUA “DUMVIRAT”- I BALL-LEGALITET PA DIJENINE E ZOGUT

NGA MARK BRUNGA

# PS tregon forcë, Rama e Tahiri renditet të 6-ët, Ruçi i 9-ti

## Kreu i PS: PD do të hyjë në zgjedhje, gati ta regjistrojmë jashtë afatit edhe për Kavajën

**ESIONA KONOMI**  
TIRANE

**F**orcë apo ftesë? Një prej të dyjave është mesazhi që Edi Rama i përcolli dje spektrit politik në vend e kryesisht për opozitën, duke vendosur që të thyejë të gjitha rregullat e pashkruar, duke mos kryesuar në listën e kandidatëve, por duke zgjedhur të jetë i 6-ti në qarkun e Vlorës. Për herë të parë, një kryetar partie nuk do të jetë i pari në listë, dhe po ashtu, as dy figurat qendrore të tij në dy qarqet më të mëdha në vend, Ruçi në Fier dhe Saimir Tahiri në Tiranë, nuk do të jenë të parët e listës. Gramoz Ruçi do të jetë i nënti në listën e qarkut të madhe e të majtë të Fier-

it, ndërsa Tahiri, sikundërse Rama, do të jetë i gjashti në listën e Tiranës. Kështu, në vend të Ramës kryeson Gjinknuri në Vlorë, në krye të Tiranës është zëvendësministrja e brendshme, Elona Gjebrea, ndërsa në krye të listës së Fierit, është vendosur kryetari i Komisionit të Ekonomisë, Erjon Braçe. Qarqet e tjera janë drejtuar nga ministra e ish-ministra, si Bushati në Shkodër, Nikolla në Lezhë, Kodheli në Kukës, Beqaj në Dibër, Klosi në Berat, Gjermani në Durrës. Në Elbasan do të jetë një deputet, Taulant Balla kryesues, ndërsa në Korçë, zëvendëskryeministri, Niko Peleshi.

### RAMA

Në një deklaratë për shtyp në mesnatë, Rama ka sqaruar se është i gatshëm

të presë Partinë Demokratike dhe opozitën të marrë pjesë në zgjedhje edhe jashtë afatit. Kryeministri shprehu bindjen se PD do të marrë pjesë në zgjedhje. "Unë vazhdoj të mendoj që PD do të hyjë në zgjedhje jam i bindur që nuk është iluzion por reale, pasi e kam pasur gjithmonë këtë bindje. Jam besimplotë që ne do të mund t'i krijojmë PD dhe partive të tjera rreth saj mundësinë që të regjistrohet natyrisht në formatin aktual secili më vete, edhe jashtë afatit. Në një afat mundësisht për të përgatitur fletët e votimit dhe patjetër gati t'i ofrojmë që në 7 maj të shkojë me një kandidat në Kavajë dhe një turmë njerëzish", tha kreu i PS-së. Ai tha se veç datës së zgjedhjeve dhe vettingut, do ta toleronte përsëri PD-në, në të gjitha kushte e ofruara nga negociatorët e huaj. "Ne nuk e presim PD dhe nuk kemi ndërmend të ndalemi nëse PD do të kërkojë që të bashkëngjitet këtij procesi në një kohë të arsyeshme ne nuk do të themi jo dhe madje unë jam i përgatitur 'PO' edhe për të gjitha kërkesat e parashtruara në platformën e kompromisit nga miqtë e PD, të PPE, duke përjashtuar afatin e zgjedhjeve, ndërsa të tjerat janë të gjitha në tavolinë, por duhet të merremi vesh pak për Vettingun", tha Rama. Ai ka shpjeguar se pse vendosi të mos e kryesojë listën



### PD-ja

"Unë vazhdoj të mendoj që PD do të hyjë në zgjedhje jam i bindur që nuk është iluzion, por reale, pasi e kam pasur gjithmonë këtë bindje. Ne do të mund t'i krijojmë PD mundësinë që të regjistrohet edhe jashtë afatit".



### Braho

"Nuk ka qenë deputet i LSI në kuptim juridik, por i PS. Ka një rol të posaçëm në marrëdhëniet mes dy partive kur është kohë e nxehtë dhe eksperiencë, asnjëherë nuk ka qenë pengesë, zjarrnxitës, por urë kur na është dashur për të kaluar".

### Oferta

"Unë jam i përgatitur për 'PO' edhe për të gjitha kërkesat e parashtruara në platformën e kompromisit nga miqtë e PD, të PPE, duke përjashtuar afatin e zgjedhjeve, por duhet të merremi vesh pak për Vettingun".

e Vlorës. "Jo ftesë për PD, por bindje se kush ka përgjegjësi më të mëdha do të marrë, jo riskun, por duhet të japë shumë. Gramoz ka vendosur aty ky është objektivi i PS në zgjedhje, unë po ashtu, pasi udhëheqësi i qarkut është Gjinknuri dhe jo unë dhe meriton të jetë drejtuesi politik", tha Rama. Sa i takon kandidimit të Spartak Brahos, kryeministri ka thënë se ai juridikisht s'ka qenë asnjëherë deputet i LSI-së. "Përsa i përket Brahos, nuk ka qenë deputet i

LSI në kuptim juridik, por i PS. Ka një rol të posaçëm në marrëdhëniet mes dy partive kur është kohë e nxehtë dhe eksperiencë, asnjëherë nuk ka qenë pengesë, zjarrnxitës, por urë kur na është dashur për të kaluar", tha Rama.

## LISTA E KANDIDATEVE PER DEPUTETE TE PARTISE SOCIALISTE

QARKU SHKODËR	
1.	Ditmir Bushati
2.	Paulin Stërkaj
3.	Senida Mesi
4.	Luan Harusha
5.	Paulin Luli
6.	Teuta Shala
7.	Alfons Babani
8.	Vilson Masmalaj
9.	Majlinda Laçaj
10.	Myzafer Bushi
11.	Pjetër Nika
12.	Bledjana Nika
QARKU LEZHË	
1.	Lindita Nikolla

2.	Pjerin Ndreu
3.	Gjetan Gjetani
4.	Ardjana Jaku
5.	Fran Mata
6.	Eglli Dashi
7.	Edona Daçi
8.	Elton Suthi
DIBËR	
1.	Ilir Beqaj
2.	Almira Xhembulla
3.	Halit Palamani
4.	Mylfit Dyriçi
5.	Naim Asllani
6.	Lindita Tako

ELBASAN	
1.	Taulant Balla
2.	Evis Kushi
3.	Arben Kamami
4.	Musa Ulqini
5.	Anastas Angjeli
6.	Luan Duzha
7.	Nure Belba
8.	Florenc Spaho
9.	Desantila Tahiraj
10.	Edmond Xhani
11.	Enver Shkurti
12.	Klevis Xhoxhi
13.	Arben Ruçi
14.	Ana Muça

15.	Ejvis Pila
16.	Besjan Ajazi
17.	Mariglen Disha
18.	Klodiana Zdrava
19.	Erjona Ibra
QARKU VLORË	
1.	Damian Gjinknuri
2.	Vilma Bello
3.	Alket Hyseni
4.	Vullnet Sinaj
5.	Andrea Marto
6.	Edi Rama
7.	Edmond Leka
8.	Fatmir Velaj
9.	Eltjona Hoxha

10.	Ramiz Husi
11.	Adrian Hurma
12.	Edjona Hodaj
13.	Saniela Xhaferri
14.	Lindita Kondi
15.	Suela Kokolloshi
QARKU GIROKASTËR	
1.	Blendi Çuçi
2.	Mirela Kumbaro
3.	Flamur Golemi
4.	Laert Duraj
5.	Artemis Dralo
6.	Matilda Cela
7.	Elvira Pasho

QARKU KORÇË	
1.	Niko Peleshi
2.	Eduard Shalsi
3.	Elisa Spiropali
4.	Ilirjan Pendavinji
5.	Ilir Xhakolli
6.	Edlira Bode
7.	Ardit Konomi
8.	Estevera Zake
9.	Sotiraq Bratko
10.	Gentjana Dravo
11.	Zamira Meto
12.	Edlira Donevski
13.	Erjon Qirjako



## NUK RIKANDIDOJNE

TIRANË		KORÇË	
1	Erjeta Alhysa	1	Ylli Ziçishti
2	Enkelejda Shkreli	2	Arta Dade
3	Artan Gaçi	VLORË	
4	Dashamir Peza	1	Valentina Lekaj
FIER		2	Fatmir Toçi
1	Pirro Lutaj	3	Koço Kokëdhima
2	Arben Çuko	4	Mira Shehu
DURRËS		ELBASAN	
1	Esmeralda Shkju	1	Ben Blushi
2	Gentjan Bejko	2	Alfred Peza
3	Shkëlqim Troplini	3	Luljeta Arapi
4	Namik Dokle	DIBËR	
KUKËS		1	Shkëlqim Cani
1	Vexhi Mucmataj	SHKODËR	
BERAT		1	Mimoza Hafizi
1	Eduard Bejko	2	Namik Kopluku
2	Anila Agalliu	3	Tom Doshi
		LEZHE	
		1	Eduard Ndocaj
		2	Armando Prenga

ESIONA KONOMI  
TIRANË

Kryesia e Partisë Socialiste ka miratuar mbrëmë në orët e vona listën finale të kandidatëve për 12 qarqet e vendit. Plot 28 deputetë, të cilët ishin zgjedhur në legjislaturën e shkuar në listën e Partisë Socialiste, nuk janë rikandiduar më, ndërsa kanë surprizuar besimet që Rama ju ka dhënë disa drejtorëve të rëndësishëm të tij. Emri që ka habitur më shumë me mungesën e saj në listë, dhe që nuk kishte njoftuar paraprakisht largimin e saj, është Kryetarja e Komisionit të Jashtëm, **Arta Dade**. Deputetja me karrierë të gjatë parlamentare ishte zgjedhur së fundmi deputete në Korçë dhe ka pasur disa poste ministore në qeveritë socialiste. Në qarkun Tiranë mungojnë dy deputetë e futura me shtesa në këtë legjislaturë që mbaron: **Erjeta Alhysa** dhe **Enkelejda Shkreli**. **Artan Gaçi** kishte njoftuar edhe më parë moskandidimin, ndërsa nuk do të jetë më në parlament as **Dashamir Peza**. Fier mungojnë dy deputetë të Komisionit të Sigurisë Kombëtare, **Pirro Lutaj** dhe **Arben Çuko**. Në Durrës mungojnë **Esmeralda Shkju**, **Gentjan Bejko** dhe **Shkëlqim Troplini**. **Namik Dokle** kishte njoftuar përpara dy vjetësh se ky do të ishte mandati i tij i fundit. Në Kukës nuk rikandidon më **Vexhi Mucmataj**, ndërsa në Berat nuk janë më dy deputetët **Eduard Bejko** dhe **Anila Agalliu**.

# Rama lë jashtë 28 deputetë aktualë, habit largimi i Dades

## Ministrja Harito rrezikon, në dyshime Braho, shpërblehen Spiropali e Hyseni

Në Korçë mungon mjeku **Ylli Ziçishti** dhe **Arta Dade**. Në Vlorë njoftoi dje tërheqjen **Valentina Lekaj**, ndërsa nuk do të jetë as **Fatmir Toçi**. Siç pritej, nga lista e shkuar mungon **Koço Kokëdhima** dhe mikeshja e tij, **Mira Shehu**. Në Elbasan



nga lista e shkuar mungojnë **Ben Blushi**, **Alfred Peza** dhe **Luljeta Arapi**. Në Dibër mungon ish-ministri **Shkëlqim Cani**, ndërsa në Shkodër siç pritej mungojnë **Mimoza Hafizi** dhe **Tom Doshi**, ndërsa habit largimi i **Namik Kopluku**. Nga lista e Lezhës mungon deputeti **Eduard Ndocaj**. Nga lista është dukshme që të gjithë ministrat janë vlerësuar duke qenë në kryesimin e listës ose në vende të sigurta. E vetmja ministre që rrezikon është **Milena Harito** e cila renditet e 21-ta në Tiranë, ndërsa funksionari i LSI-së, **Spartak Braho**, që do të rikandidojë përsëri në emër të PS-së, është po ashtu në një vend të diskutueshëm, në vend të 19-të. Vihet re se Rama ka shpërblyer mirë ish-drejtoreshën e Doganave, **Elisa Spiropali**, duke e vendosur të tretë në Korçë, e po të njëjtin vend i ka dhënë dhe ish-drejtorit të Parandalimit të Pastrisë të Parave, **Alket Hyseni**. Hyseni duket se është shpërblyer për besnikërinë

### HARITO

E vetmja ministre që rrezikon është **Milena Harito** e cila renditet e 21-ta në Tiranë, ndërsa funksionari i LSI-së, **Spartak Braho**, që do të rikandidojë përsëri në emër të PS-së, është po ashtu në një vend të diskutueshëm, në vend të 19-të.

ndaj Ramës, ku në detyrën e Komisionit të Garancive Statutore në PS, kur Blushi pretendonte të zhvillonte zgjedhje në PS kundër Ramës, ai dha verdikt kundër hipotezave të Blushit. Më pas, për hir të ligjit të vettingut dhe rritjes së besimit të opozitës, Hyseni u dorëhoq nga detyra e DPPP, duke demonstruar një akt të vlerësuar nga kryeministri. Ai do të jetë i treti në Vlorë, përgjegjës për zonën e Sarandës.

QARKU BERAT	
1.	Blendi Klosi
2.	Ermonela Felaj
3.	Adnor Shahmeti
4.	Fadil Nasufi
5.	Arben Konomi
6.	Eugen Kallfani
7.	Sajmir Plaku
8.	Jorid Celaj
QARKU KUKËS	
1.	Mimi Kodheli
2.	Safet Gjici
3.	Valbona Doçaj
4.	Agron Geca

QARKU DURRËS	
1.	Eglantina Gjermeni
2.	Milva Ekonomi
3.	Fidel Ylli
4.	Ilir Drazhi
5.	Roland Xhelili
6.	Jurgen Çyrbja
7.	Rraman Rranja
8.	Klodjana Spahiu
9.	Altin Gazaj
10.	Alban Ramohito
11.	Ledjon Lako
12.	Ana Dharmo
13.	Bashkim Xhafa

14.	Agron Hyska
15.	Agim Karaj
QARKU FIER	
1.	Erjon Braçe
2.	Adelina Rista
3.	Bashkim Fino
4.	Ismir Beqiri
5.	Antoneta Dhima
6.	Bujar Çela
7.	Tatjana Pirro
8.	Anduel Xhindi
9.	Gramoz Ruçi
10.	Xhavit Bushi
11.	Gentiana Cakrani
12.	Lindita Buxheli

13.	Ervin Bushi
14.	Gentian Nushi
15.	Ermal Petushi
16.	Afrim Taga
QARKU TIRANË	
1.	Elona Gjebrea
2.	Besnik Bare
3.	Olta Xhaçka
4.	Blerina Gjylmetaj
5.	Pandeli Majko
6.	Samiri Tahiri
7.	Vasilika Hysi
8.	Ervin Bushati
9.	Ogerta Manastirliu

10.	Fatmir Xhafaj
11.	Rakip Suli
12.	Arben Ahmetaj
13.	Xhemal Qefalia
14.	Sadri Abazi
15.	Ulsi Manja
16.	Klotilda Ferhati
17.	Sadri Vorpsi
18.	Arben Pllumbi
19.	Spartak Braho
20.	Eljo Hysko
21.	Milena Harito
22.	Silda Cepe
23.	Danja Obdari

24.	Juljana Hoxha
25.	Arben Seferi
26.	Blerina Doracaj
27.	Irma Shtini
28.	Besa Spaho
29.	Granit Axhalliu
30.	Shpëtim Leskaj
31.	Azbi Arapi
32.	Dritan Meta
33.	Klevis Jahja
34.	Gerta Lubonja
35.	Ruida Lita
36.	Shpat Kolegega
37.	Arben Mecaj

# Zbardhet lista e LSI, ja kush kryeson në qarqe

## Ylli Manjani: Unë në listë jo për deputet, por formalisht. Regon Ilir Meta: Nuk pranoi



Lëvizja Socialiste për Integrim ka dorëzuar në limitet kohore në Komisionin Qendror të Zgjedhje listën e kandidatëve për zgjedhjet e 18 Qershorit. Lista e LSI në të gjitha qarqet, por sidomos në Tiranë, është e mbushur me shumë të rinj nga LRI. Gjithashtu LSI ka rikthyer në lista për kandidatë për deputetë edhe ministrat e larguar Nasip Naço dhe Edmond Haxhinasto. Në Tiranë listën e kryeson ministrja Klajda Gjoshja, ndërsa kryetari i grupit Luan Rama do të jetë në pozicionin e pestë. Ilir Meta, gjatë një konferenca për shtyp tha se Luan Rama kandidon pikërisht në atë pozicion ku do të garonte ai nëse nuk do të ishte zgjedhur President. Ndërkaq, pas zonzës Gjoshja, vijnë Kejdi Mehmetaj, Floida Kërpaçi dhe Endrit

Braimllari. Ndërkaq, Në Vlorë qarkun e kryeson Shezai Rrokaj, i ndjekur nga ministri Sokol Dervishaj. Në Shkodër i pari është Agron Çela, në Lezhë Viktor Tusha, ndërsa në Kukës vajza e Shpresa Beçajt, Selvi Beçaj. Në Korçë, ashtu sikur tha edhe Meta do të jetë Edmond Panariti, në Gjirokastrë Vangjel Tavo, në Fier Petrit Vasili, në Elbasan do të jetë Monika

Kryemadhi, në Durrës Lefter Koka, në Dibër Përparim Spahiu dhe në Berat Nasip Naço.

### YLLI MANJANI

Ish-ministri i LSI, Ylli Manjani, ka sqaruar dje përfshirjen e emrit të tij nga Meta në listat për deputetë. Manjani sqaroi se përfshirja e tij në lista ka qenë thjesht formale ndërsa shton se politika bëhet dhe pa qenë

deputet në Parlament. “Sa i takon lajmit të “jashtëzakonshëm” të futjes sime në listë, sqaroj se: Sot jam propozuar për të qenë thjesht listë, por jo për deputet! LSI vijoj t’i jem mirënjohës, por politika bëhet edhe si qytetar i lirë! Këtë kam bërë gjithmonë!”, shkruan Manjani në rrjetin social, Facebook. Ndërkaq, gjatë konferencës për shtyp ku prezantoi listën për qarkun e Tiranës, Ilir Meta ka komentuar tërheqjen e Ylli Manjanit duke deklaruar se ai nuk pranoi. “Unë nuk komunikoj me statuse, por në mënyrë institucionale, aq më tepër me anëtarët e Kryesisë, ku secili merr vendimin e tij. Nuk ka pranuar që të jetë në listë. Listat i bëjnë forumet, unë vazhdoj të jem kryetar deri në mbrëmje. Falënderoj Luan Ramën dhe të tjerët që e përqafojnë me bindje sloganin ‘të rinjtë janë të parët’, tha ai.

## LISTA E KANDIDATËVE PËR DEPUTETË TË LËVIZJES SOCIALISTE PËR INTEGRIM

QARKU TIRANË			
1	Klajda	Theodhoraq	Gjoshja
2	Kejdi	Fatmir	Mehmetaj
3	Floida	Fadajev	Kërpaçi
4	Endrit	Vullnetar	Braimllari
5	Luan	Mersin	Rama
6	Klevi	Bujar	Pojana
7	Ardit	Petrit	Çela
8	Eriona	Pullumb	Bixha
9	Ylli	Vesel	Shehu
10	Edmond	Abaz	Rrushu
11	Ralf	Dhimitër	Gjoni
12	Rea	Robert	Kotani
13	Adela	Sabri	Karapici
14	Petrit	Sami	Vargu
15	Dejana	Bozho	Kallogjeroviç
16	Fiona	Naim	Dani
17	Kristi	Albert	Xharau
18	Fatos	Nazemi	Kaja
19	Lindita	Veli	Karadaku
20	Kevin	Osman	Topi
21	Edmond	Bajram	Stojku
22	Ramazan	Asim	Gjuzi
23	Fatjola	Jahja	Halilaj
24	Ira	Genci	Vejsiu
25	Tea	Petrit	Islamaj
26	Bora	Athim	Panajoti
27	Anxhela	Thanas	Poçi
28	Sidiola	Gëzim	Basho
29	Rigels	Theodhor	Gjikdhima
30	Sara	Abaz	Lleshi
31	Erklent	Astrit	Krifsa
32	Muharrem	Isa	Berisha
33	Agron	Selim	Xhafa
34	Gaetano	Aleks	Doçi
35	Amela	Dylaver	Shkoza
36	Ana	Ali	Azizaj

4	Flamur	Rrapo	Çelaj
5	Eldisa	Asqeri	Doka
6	Reni	Rexhep	Barjami
7	Namik	Sali	Jahaj
8	Entela	Lutfi	Shkurtaç
9	Vasil	Aristidh	Agjeli
10	Anxhela	Robert	Mustafa
11	Ervin	Asllan	Baçaj
12	Monika	Lavdosh	Hitaj
13	Klajdi	Dervish	Mati
QARKU SHKODËR			
1	Agron	Elez	Çela
2	Dritan	Rifat	Hylli
3	Amra	Luan	Barova
4	Sajmira	Adem	Laçi
5	Lidra	Shefik	Bushati
6	Lindita	Beqir	Kraja
7	Ritvana	Kadri	Rrukaj
8	Edmond	Kol	Ndou
9	Estela	Harallamb	Nika
10	Shpëtim	Ali	Lame
11	Vehbi	Ali	Shkëjau
QARKU LEZHË			
1	Viktor	Mark	Tushaj
2	Gjovalin	Pjeter	Kadeli
3	Elda	Artan	Hoti
4	Petrit	Preng	Gjoni
5	Pjeter	Ndue	Ndoj
6	Artan	Ymer	Djala
7	Sabaete	Fatmir	Hidri
8	Joana	Frrok	Kaçorri
QARKU KUKËS			
1	Selvi	Ramadan	Beçaj
2	Sokol	Rexhep	Ponari
3	Dem	Azem	Brati
QARKU KORÇË			
1	Edmond	Qamil	Panariti
2	Piro	Leonidha	Kapurani
3	Brunilda	Kozma	Paskali

4	Gentian	Roland	Çala
5	Vasil	Kërstin	Sterjovski
6	Anila	Bashkim	Hoxha
7	Petrika	Thomaq	Mele
8	Floalda	Alfredi	Strati
9	Ilir	Muhamet	Cenolli
10	Stefan	Gjergji	Gërmenji
11	Aida	Fatmir	Musollari
12	Eftim	Bosilko	Mitre
QARKU GIROKASTËR			
1	Vangjel	Llambi	Tavo
2	Ediola	Përparim	Braha
3	Gjergji	Leonidha	Petro
4	Entela	Stefan	Ibrahimi
5	Freskida	Maksi	Çako
QARKU FIER			
1	Petrit	Kozma	Vasili
2	Robert	Thoma	Bitri
3	Erisa	Piro	Xhixho
4	Nimet	Aqif	Musai
5	Klajdi	Arben	Bogdanaj
6	Ilir	Islam	Dervishi
7	Agim	Nasi	Sema
8	Agim	Tari	Rrasa
9	Bardhi	Dervish	Meli
10	Marsela	Mitat	Ahmetaj
11	Ardit	Sami	Sinani
12	Alma	Luftar	Malia
13	Besmir	Përparim	Gropa
14	Arian	Abedin	Faskaj
15	Besa	Veli	Hyka
16	Xherila	Perparim	Musaku
QARKU ELBASAN			
1	Monika	Ramazan	Kryemadhi
2	Edmond	Llazar	Haxhinasto
3	Enver	Mersin	Roshi
4	Zenun	Selim	Bullari
5	Altin	Sulejman	Idrizi
6	Rudina	Jani	Mita
7	Suzana	Skënder	Topi

8	Admirim	Fidai	Kala
9	Edlira	Nuri	Çekrezi
10	Afërdita	Hamdi	Gjata
11	Mitat	Halil	Gjura
12	Anisa	Gëzim	Bahiti
13	Andi	Ramazan	Shtylla
14	Klevis	Ymer	Delishi
QARKU DURRËS			
1	Lefter	Haki	Koka
2	Nora	Dod	Malaj
3	Flamur	Pellumb	Gjuzi
4	Arb	Shkëlqim	Shtylla
5	Agim	Haki	Xheka
6	Edlira	Adem	Hyseni
7	Albert	Pullumb	Gjoka
8	Geraldo	Luan	Shkodra
9	Ferdoza	Enver	Izvira
10	Arben	Sadik	Qato
11	Skardi	Ardian	Bello
12	Xhojana	Abedin	Gjineci
13	Eneo	Xhelal	Hasa
14	Arjola	Arben	Koçi
QARKU DIBËR			
1	Përparim	Islam	Spahiu
2	Aurora	Xhavit	Mara
3	Rahim	Nexhmi	Kaleci
4	Anila	Qamil	Sela
5	Ilirjana	Sali	Kaceli
6	Nedion	Musa	Muça
QARKU BERAT			
1	Nasip	Qani	Naço
2	Gledjon	Tomorr	Rehovica
3	Silva	Maksim	Caka
4	Llambriola	Dhimitër	Misto
5	Taulant	Roland	Vrapit
6	Eugen	Dhimo	Bojaxhiu
7	Klajdi	Selim	Qama
8	Rexhina	Shkëlqim	Limja

## PRESIDENCA / BERISHA: NUK KISHIM AMBICIE

## Meta President, Berisha: Rama mbylli çdo shteg të opozitës

Ish-kryeministri Sali Berisha ka thyer heshtjen, duke komentuar për herë të parë zgjedhjen e Ilir Metës President të vendit. E ndërsa shprehet se posti i Presidentit nuk ishte në ambicien e opozitës, mënyra e zgjedhjes, sipas Berishës ishte një akt i ri për thellimin e krizës politike në vend. Berisha anashkallon figurën e Metës, ndërsa ka hedhur akuza në adresë të kryeministrit Edi Rama. “Një akt i ri për thellimin krizës! Dje parlamenti i “ale-

## BERISHA

“Opozita sigurisht nuk kishte asnjë ambicie për pushtet në tavolinë apo për postin e presidentit. Ajo ka shpallur si mision të vetin rikthimin e votës së lirë për shqiptarët dhe jo ndarjen në tavolinë të pushtetit”.

ancës së qelbësirave” apo i Narko-Republikës, votoi, me urdhër të Norieges, Ilir Metën, kryetarin e Parlamentit dhe kryetarin e LSI si President të ardhshëm të vendit.

Opozita sigurisht nuk kishte asnjë ambicie për pushtet në tavolinë apo për postin e presidentit. Ajo ka shpallur si mision të vetin rikthimin e votës së lirë për shqiptarët

dhe jo ndarjen në tavolinë të pushtetit”, shkruan Berisha. Ish-kryeministri deklaroi se me zgjedhjen e Metës President, Edi Rama vrapoi të solidifikojë qëndrimin e aleancës kundër kërkesës së opozitës për zgjedhje të lira dhe për të mbyllur çdo shteg apo mundësi për të lejuar shqiptarët të votojnë të lirë. “Por me këtë veprim, që në stilin atëror të Edi Ramës ngjan me ngritjen në përgjegjësi para eliminimit, pra me zgjedhjen e Metës president,



Edi Rama vrapoi të solidifikojë qëndrimin e “aleancës së qelbësirave” kundër kërkesës së opozitës për zgjedhje të lira dhe për të mbyllur çdo shteg apo mundësi për të lejuar shqiptarët të votojnë të lirë dhe për të zgjidhur në mënyrë

të civilizuar krizën më të rëndë dhe më të rrezikshme që përjeton Shqipëria nga shkurti i vitit 1991. Qytetarët shqiptarë do t'i japin Edi Ramës ndëshkimin e merituar! Revolucioni demokratik do fitojë”, shkruan Berisha.

## Dorëheqja



## Ilir Meta: Largoohem nga LSI, nga sot do takoj Lulzim Bashën

ADRIATIK DOÇI  
TIRANE

Presidenti i sapozgjedhur: Heq dorë nga të gjitha funksionet drejtuese në partinë Lëvizja Socialiste për Integrim

Presidenti i sapozgjedhur i Republikës, Ilir Meta, ka deklaruar dje se nuk do të jetë më kryetar i Lëvizjes Socialiste për Integrim, por do të qëndrojë në krye të Kuvendit deri në seancën e fundit. Edhe pse ka ende kohë për të bërë betimin për President, Ilir Meta tha se nuk do të ushtonte më funksione politike, duke ia drejtimitin e LSI, Petrit Vasilin. Ditën e zgjedhjes Meta pohoi se do të qëndronte në krye të LSI deri në 24 korrik, por një ditë më pas e ka korrigjuar deklaratën. “Së dyti, edhe pse mund të vazhdojë të jem kryetar i LSI-së, deri në 23 korrik, kam vendosur që sot në mbrëmje, pas përfundimit të listave të kandidatëve për deputet nga Kryesia e Lëvizjes Socialiste për Integrim, të heq dorë nga ky funksion dhe nga të gjitha funksionet drejtuese në Lëvizjen Socialiste për Integrim. Po kështu në listën e partive që do të dorëzohen dhe që do të publikohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për qytetarët shqiptar, në kraht të Lëvizjes Socialiste për Integrim nuk do të jetë emri i Ilir Metës, por do të jetë emri i Petrit Vasilin si Zëvendëskryetar deri tani i LSI-së, i cili sipas statutit të Lëvizjes Socialiste për Integrim merr drejtimitin e kësaj force politike për të cilën natyrisht do të shprehet edhe Komiteti Drejtues Kombëtar i Lëvizjes Socialiste për Integrim në ditët që vijnë dhe do të shprehet në votim edhe Konventa Kombëtare e LSI-së brenda javës së ardhshme”, tha Meta.



**Për Bashën**  
“Do të përiqem duke filluar nga sot, ose më saktë nga nesër, kur të mos kem asnjë detyrim si Kryetar i Lëvizjes Socialiste për Integrim, të takohem me Kryetarin e PD, z. Basha”.

marrë pas konsultimeve me këshilltarët e tij. “Jam këtu për t'u dhënë përgjigje disa pyetjeve që më bëtë dje, për të cilat isha i papërgatitur. Pas edhe konsultimeve me këshilltarët juridik, edhe pse detyrimet e mia si President i ardhshëm fillojnë pas betimit si President në Kuvendin

e Shqipërisë, në 24 korrik dhe deri atëherë mund të vijoj me të gjitha cilësitë e angazhimit e mia politike dhe institucionale, mund t'u bëj të ditur se do të vijoj të jem Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë deri në ditën e betimit si President i vendit. Pra, do të japë dorëheqjen përpara këtij

betimi për arsye të vetë lidhjes midis këtyre dy institucioneve edhe në planin kushtetues, edhe në planin institucional. Por, edhe për faktin se të enjten e ardhshme do të jetë seanca e fundit plenare. Kështu që për të gjitha këto arsye do të vijoj të jem në këtë detyrë deri përpara betimit si President”, tha Meta.

## TAKIMI ME BASHËN

Presidenti i sapozgjedhur i Republikës, Ilir Meta tha se nga sot do të përiqet të takojë kryetarin e opozitës, Lulzim Bashën, për të gjetur një zgjidhje politike. Meta shtoi se zgjedhjet duhet të jenë një festë e demokracisë dhe jo burim pasigurie. “Do të përiqem duke filluar nga sot, ose më saktë nga nesër, kur të mos kem asnjë detyrim si Kryetar i Lëvizjes Socialiste për Integrim, të takohem me Kryetarin e Partisë Demokratike, z. Basha, në çdo moment, por njëkohësisht do të përiqem ditët që vijnë të forcoj bashkëpunimin me Presidentin Nishani. Por edhe nëse do të jetë e nevojshme për t'u takuar, bashkëbiseduar, edhe me ish-presidentët e vendit për shkak të përvojës dhe eksperiencës që ata kanë, apo ish-kryetarët e Kuvendit dhe drejtues të tjerë me përvojë dhe me eksperiencë për të kërkuar kontributin e të gjithëve që të krijojmë një klimë mirëbesimi, normaliteti, paqeje dhe atmosferë demokratike në vend. Sepse po shkojmë drejt zgjedhjeve dhe ato duhet të jenë një festë e demokracisë dhe jo një burim i pasigurisë për qytetarët dhe për të ardhmen e institucioneve tona”, tha Meta.

## Kreu i PD-së

## Basha: Zgjedhja e Presidentit pazari i fundit i republikës së vjetër

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha e ka konsideruar si kurorëzim i pazarit të republikës së vjetër zgjedhjen e Presidentit të ri të Republikës. “Pazari i republikës së vjetër u kurorëzua dje me zgjedhjen e presidentit, me caktimin e presidentit nga pazari i Pazarit të Ri. E dua demokracinë, thotë presidenti i sapozgjedhur, dhe ja, po e shijoj demokracinë. Por kjo nuk është demokracia e vërtetë. Pazari mbi shishet e verës, që kushtojnë më shumë se pensionet e një qyteti të vogël, për të zgjedhur presidentin nuk është demokraci e vërtetë. Nuk përfaqëson as vullnetin e popullit dhe as gjendjen kritike të përplasjes sociale dhe krizën politike në vend”, tha Basha në ditën e 71 të protestës.



Kreu i PD shtoi se ky është kapitulli i fundit i pazarit politik. “Ky është thjesht dhe vetëm kapitulli i fundit i pazarit politik të republikës së vjetër, mekanizmit që ka mbajtur në këmbë dhe ka ushqyer tash 4 vite këtë komplot ekonomik që ka zhveshur shqiptarët nga fuqia blerëse, që ka shpunësuar bijtë dhe bijat e tyre. Që ka bërë prindërit të paguajnë tarifa më të larta për universitetet, që ka dërguar pacientët dhe familjet e tyre në një sistem shëndetësor të falimentuar. Që ka krijuar një shtet të falimentuar, të korruptuar e të inkriminuar deri në palcë”, pohoi Basha. Kreu i PD i ka dhënë një mesazh edhe Ilir Metës. “Le ti themi sot, se për ne, Partinë Demokratike dhe gjithë qytetarët që na besojnë, Ilir Meta është vetëm afër pazarit të peshkut që është qelbur nga koka ndaj Edi Rama ta gëzosh ti, atë, dhe peshkun e qelbur nga koka. Ne nuk kemi ardhur në këtë betejë për pazare të fëlliqura politike. Ne nuk kemi ardhur në këtë betejë për pushtetin tonë”, tha Basha.

## NJOFTIM

## I. SHOQËRIA PËRMBARIMORE “616/A” SHPALL PËR SHITJE NË ANKAND PASURINË E PALUAJTSHME:

Ndërtesë me sip. 188 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie 252/94, vol.2, faqe nr. 123 e ndodhur në zonën kadastrale nr.2722 Drenovë, Korçë.

Vlera fillestare e pasurisë është **1.183.200 lekë** ( Njëmiljon e njëqind e tetëdhjet e tre mijë e dyqind).

ANKANDI ZHVILLOHET DITËN E MËRKURË NË DATË 03.05.2017

Personat e interesuar mund të paraqiten në adresën Lagjja Nr.3, Rruga “Andon Xoxe”, Pogradec ose të kontaktojnë në numrin 0662036006 ose në e-mail: shoqeria616a@gmail.com

## VENDIMI

Presidenti i sapozgjedhur shtoi se këtë vendim e kishte

## ZGJEDHJET / KREU I PD: PS-LSI KANË SHKELUR AFATET

## Basha: 18 Qershori është asgjësuar si datë për zgjedhjet

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, gjatë fjalës së tij në ditën e 71 të protestës me turne para Kryeministrit, tha se 18 Qershori është asgjësuar si datë për zhvillimin e zgjedhjeve parlamentare. Basha shtoi se afati për regjistrimin e listave për kandidatë ka përfunduar që në datën 28 Prill. “Vetë procesi elektoral ka kolapsuar edhe në kuptimin ligjor të fjalës. Mbrëmë në mesnatë, ka skaduar afati i fundit i Kodit Zgjedhor për dorëzimin e listave emërore të kandidatëve për deputetë të atyre partive që ishin regjistruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Bëhet fjalë kryesisht për partitë e pushtetit, për partinë e Edi Ramës dhe partinë e Ilir

## → BASHA

“Mbrëmë në mesnatë, ka skaduar afati i fundit i Kodit Zgjedhor për dorëzimin e listave emërore të kandidatëve për deputetë të atyre partive që ishin regjistruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve”.

Metës. Deri tani, asnjë prej këtyre partive kryesore të pushtetit nuk kanë dorëzuar listat emërore të kandidatëve. Me këtë akt, dhe sipas Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, në këtë moment është asgjësuar 18 Qershori si një datë ligjore për zgjedhje në Republikën e Shqipërisë”, tha Basha. Megjithatë, Basha shtoi se mazhoranca nuk do që t’ia dijë për ligj. “Atë, që kjo lëvizje

dhe ky bashkim qytetar, e ka asgjësuar përmes qëndresës demokratike dhe paqësore, atë që ju e keni asgjësuar politikisht mbrëmë në mesnatë, dy partitë duke mos dorëzuar listën e tyre shumëemërore, e kanë asgjësuar edhe ligjërisht. Natyrisht në këto katër vite, jo zbatimi i ligjit por shkelja e tij ka qenë tipari i kësaj qeverisje dhe me siguri tellalët do të dalin sot me lloj-lloj justifi-

kimesh e interpretimesh, se pse data nuk ishte dje, por ishte sot. Nuk kam ndërmend dhe nuk ju ftoj ta ndiqni këtë shfaqje të shëmtuar. Fakti është se data ka skaduar. Fakti është, po kështu, se këta nuk duan t’ia dinë as për ligj, as për Kod Zgjedhor dhe as për Kushtetutë. Ndaj, është në dorën tonë të vazhdojmë së bashku”, pohoi kreu i PD. Basha shtoi se opozita është para dy rrugëve. “Dy janë mundësitë para nesh. E para që republika e vjetër të vazhdojë avazin e saj. Asgjë nuk do të ndryshojë. Gjerat do të shkojnë keq e më keq me një tjetër parlament dhe një tjetër qeveri të zgjedhur, jo nga populli, por nga krimi, droga dhe paratë e korrupsionit. Ftesa ndaj opozitës, Partisë Demokra-



tike dhe meje personalisht dhe presioni ndaj nesh ka një qëllim; që të bëhemi pjesë e këtij pazari të fëlliqur, alibi dhe perde për një proces zgjedhor të paracaktuar nga krimi dhe droga. Ne i kemi thënë jo. Unë i them jo e do të vazhdoj ti them jo deri në fund. Rruga tjetër para nesh, është të vazhdojmë këtë betejë për votën e lirë, themelin e bashkëjetesës demokratike”, pohoi Basha.



## Afati për listat

# PD kërkon refuzimin e kandidatëve, rrëzohet nga KQZ

## Opozita: KQZ të mos pranojë listat, të shtyhen zgjedhjet me marrëveshje politike

## → KËRKESA E PD

Teksa pritej ndonjë lëvizje surprizë e opozitës, deputeti demokrat Oerd Bylykbashi i kërkoi dje KQZ që të mos regjistrojë kandidatë për deputetë, pasi sipas tij afati kishte mbaruar në datën 28 prill.

lista”, tha Bylykbashi. Në këtë kuadër, deputeti i PD ka artikuluar një mesazh në adresë të KQZ. “Nëse e bën është duke shkelur ligjin. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe askush tjetër nuk ka asnjë mundësi ligjore për të ndryshuar Kodin Zgjedhor, për të ndryshuar rregullat. Nëse e bën do të jetë haptazi jo vetëm në një paligjshmëri por haptazi edhe në një veprim të njëanshëm politik e partizan që nuk është aspak çudi me qëndrimin që ka treguar deri tani, por kjo do të ishte një paligjshmëri e hapur”, tha ai.

## ZGJIDHJA POLITIKE

Partia Demokratike ka kërkuar shtyrjen e zgjedhjeve të 18 Qershorit



me anë të një marrëveshje politike. “E theksoj, nga dita e sotme askush nuk regjistron më lista dhe nga dita e sotme ose më mirë të themi nga mbrëmë në mesnatë ka përfunduar ligjërisht, përveçse politikisht, edhe kjo farsë që u quajtën zgjedhjet e dekretuara më 18 qershor. Praktikisht dhe ligjërisht ka rënë edhe dekreti i Presidentit. E vetmja mënyrë që shqiptarët nga sot e tutje

## → REAGIMI I KQZ

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka rrëzuar pretendimet e Partisë Demokratike sa i takon afatit të fundit për dorëzimin e listave të kandidatëve për deputetë nga subjektet politike.

të votojnë të lirë në zgjedhje të lira dhe të ndershme është një marrëveshje gjithëpërfshirëse politike e cila do të mundësojë ata në një moment tjetër të votojnë me kushte të tjera dhe jo me këto që imponon kjo mazhorancë”, pohoi deputeti i PD.

## KQZ RRËZON PD

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka rrëzuar pretendimet e Partisë Demokratike sa i takon afatit të fundit për dorëzimin e listave të kandidatëve për deputetë nga subjektet politike. “Komisioni Qendror i Zgjedhjeve sqaron opinion publik se, në bazë të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, afati i regjistrimit të listave shumëemërore të kandidatëve të

partive politike, të regjistruara si subjekte zgjedhore për zgjedhjet e datës 18 qershor 2017 është “jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve”. Bazuar në rregullimin e mësipërm ligjor dhe në praktikën shumëvjeçare të KQZ, afati 50 ditë përpara datës 18 qershor 2017 korrespondon me datën 29 prill 2017. Referuar nenit 67 të Kodit Zgjedhor, partitë politike duhet të depozitojnë listat shumëemërore në KQZ, jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve. Afati 50 ditë para datës së zgjedhjeve referuar nenit 125 të Kodit Zgjedhor, llogaritet duke përfshirë ditën e zgjedhjeve”, ka sqaruar KQZ.

## LLOGARITJA

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka theksuar se data 29 Prill është pranuar edhe nga forcat politike si afati i fundit për regjistrimin e listave të kandidatëve për deputetë. “Kjo mënyrë përlllogaritje e afateve është tashmë një praktikë e ndjekur në të gjitha proceset zgjedhore të mëparshme dhe është zbatuar edhe në lidhje me përcaktimin e datës 10 prill 2017 si data e fundit për regjistrimin e subjekteve zgjedhore që do të marrin pjesë në zgjedhjet e datës 18 qershor 2017, apo të datës 19 prill, si data e fundit për regjistrimin e koalicionëve zgjedhore. Data 29 prill, si data e fundit për regjistrimin e listave shumëemërore të kandidatëve të partive politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin 2017 është datë e deklaruar prej kohësh dhe e pranuar publikisht me veprime konkludente nga të gjitha forcat politike në vend, disa prej të cilave kanë edhe përfaqësues të përhershëm në mbledhjet e KQZ”, thuhet në deklaratën e KQZ.



Skadon afati

# PD jashtë zgjedhjeve, ja 20 pasojat katastrofike

PD humbet zërin në Parlament, prezencën mediatike, selinë e partisë, komisionerët, pagat dhe ndikimin mbi drejtësinë e re

ADRIATIK DOÇI  
TIRANE

**P**artia Demokratike ka hedhur një tjetër hap në rrugën e daljes nga skena politike dhe jeta institucionale e vendit, duke humbur një tjetër mundësi, ndoshta të fundit, për të marrë pjesë në zgjedhjet parlamentare të 18 Qershorit. Mesnata e 29 prillit shënoi fundin e afatit ligjor për partitë politike për të paraqitur listën e kandidatëve për deputetë dhe për rrjedhojë edhe për regjistrimin në zgjedhjet parlamentare. Teksa pritej një reflektim në orët e fundit, partia më e madhe në opozitë, jo vetëm i qëndroi për betimit për të mos marrë pjesë në zgjedhje, por kërkoi që edhe kandidatët partive të tjera të mos pranoheshin, me argumentin që kishte skaduar afati. Në këto kushte, nëse edhe në ditët në vijim nuk do të ketë një zgjidhje emergjente, Partia Demokratike do të mbetet jashtë procesit zgjedhor, duke humbur automatikisht disa të drejta dhe privilegje jetike për një forcë politike. Partia Demokratike vijon në këtë rrugë me shpresën e zhvillimit të zgjedhjeve të parakohshme pas zgjedhjeve të 18 Qershorit. Por, edhe nëse një vit pas zgjedhjeve të 18 qershorit, shumica e re do të pranojë zhvillimin e zgjedhjeve të parakohshme, PD do të hynte në këto zgjedhje si një parti jo parlamentare, pa një sërë avantazhesh dhe fuqish që të ky status.

Shtëpia Qendrore e Ushtrisë, buron nga neni 22 i ligjit për partitë politike. Ky nen parashikon që partitë parlamentare pajisen me ndërtesë për selinë e tyre qendrore dhe zyra vendore. Kur kjo është pamundur, shteti merr përsipër pagesën e çirasë. Me bojkotin e zgjedhjeve, PD nuk është më një parti parlamentare dhe si e tillë, humbet të drejtën për të përdorur si seli të saj Shtëpinë Qendrore të Ushtrisë. Në rast bojkoti, pas zgjedhjeve të 18 Qershorit, në bazë të ligjit, PD duhet t'i dorëzojë shtetit selinë e partisë.

ka vendosur një precedent, ku shkarkoi anëtarin e LSI, sapo kjo e fundit kaloi në opozitë. Megjithatë, edhe nëse Parlamenti i ri nuk do t'i shkarkonte tre përfaqësuesit e opozitës në KQZ, kjo e fundit do t'i humbiste anëtarët pas mbarimit të mandatit të tyre.

**HUMBJET E TË DREJTAVE QË BUROJNË NGA PARLAMENTI**

Me bojkotin e zgjedhjeve, PD humbet përfaqësimin në delegacionet dhe komisionet parlamentare, për shkak se nuk është më një parti parlamentare. Gjithashtu, Partia Demokratike do të privohet nga e drejta për të ngritur komisione hetimore për çështje të ndryshme dhe nuk mund të vërë më në lëvizjes Gjykatën Kushtetuese për rrëzimin e nis-mave ligjore të mazhorancës. Gjithashtu, Partia Demokratike, me bojkotin e zgjedhjeve, humbet të drejtën për t'u përfaqësuar me anëtarë në nënkomisionet për të zgjedhur 10 anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Po ashtu, PD nuk mund të përfaqësohet më me anëtarë në komisionet që do zgjedhin anëtarët e organeve të Vetingut. Gjithashtu, PD nuk mund të bëhet më pjesë e komisioneve për ndryshimin e Kodit Zgjedhor si dhe humbet çdo mundësi për mocion mosbesimi ndaj qeverisë.

**HUMBJA E ZËRIT NË PARLAMENT DHE E PREZENCËS MEDIATIKE**

Opozita ka fjalën. Fjala është arma më e fortë e opozitës. Sali Berisha, edhe në shkelje të rregullores, ka shfrytëzuar si askush tjetër foltoren e Parlamentit, për t'i dhënë zë opozitës, për të shpërfaqur qëndrimet e saj, por edhe për të sulmuar kundërshtarët politikë. Gjatë kësaj legjislature, Berisha ka folur tre herë me shumicë se sa kryeministri. Por, nëse Partia Demokratike nuk do të marrë pjesë në zgjedhjet e qershorit, ajo do të humbasë zërin e saj në Parlament. Do të humbasë armën e saj më të fortë. Humbja e zërit në Parlament është një goditje e fortë edhe për kryetarin e opozitës, Lulzim Bashën, të cilin mosqenia deputet e vendos në pozita të disfavorshme në raport me kundërshtarin politik. Për rrjedhojë, Partia Demokratike do të humbasë edhe prezencën mediatike. Me daljen nga skena politike dhe jeta parlamentare, Partia Demokratike humbet prezencën dhe vëmendjen mediatike, e për rrjedhojë edhe vëmendjen e opinionit publik.

**HUMBJA E ANËTARËVE NË KQZ**

Gjithnjë në rast bojkoti, pas zgjedhjeve të 18 Qershorit, Partia Demokratike humbet përfaqësimin me anëtarë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe në të gjitha nivelet e tjera të komisioneve të administrimit të zgjedhjeve. E drejta për të propozuar komisionerë u lind partive të reja opozitare, të cilat marrin numrin më të madh të vendeve në Parlamentin e ri. Neni 14 i Kodit Zgjedhor parashikon që 2 anëtarë të KQZ propozohen nga partia e opozitës parlamentare që ka numrin më të madh të vendeve në Kuvendin e Shqipërisë. E njëjta formulë aplikohet edhe me komisionet e tjera. Mandati i anëtarit të KQZ është gjashtë vjet, por vetë PD, në vitin 2013,

**PRIVILEGJET E TJERA**

Partia Demokratike është një parti e madhe dhe historike, me bazë solide dhe mbështetje të gjerë. Është partia e dytë më e madhe në vend, pas Partisë Socialiste. Si e tillë, edhe në ditët më të zeza, PD merr një numër të konsiderueshëm mandatesh në zgjedhjet parlamentare. Në rast bojkoti të zgjedhjeve parlamentare të 18 Qershorit, Partia Demokratike nuk përfiton fonde vjetore nga buxheti i shtetit në bazë të numrit të deputetëve që ka marrë në zgjedhjet e fundit parlamentare, pasi PD do të figuronte me zero mandate dhe zero vota. Neni 19 i ligjit për partitë politike parashikon që 70 përqind e ndihmës shtetërore për partitë ndahet në pjesë të barabarta sipas votave të fituara në zgjedhjet fundit parlamentare. Gjithashtu, Lulzim Basha, duke humbur statusin e kryetarit të opozitës, do të humbiste të drejtën e shoqërimit me eskortë dhe benefite të tjera që burojnë nga ky status. Neni katër i ligjit për Gardën e Republikës, parashikon që Garda ruan e mbron... kryetarin e partisë më të madhe të opozitës parlamentare... Ndërkaq, duke mos qenë pjesë e parlamentit, kupola drejtuese e PD, humbet edhe njëfarë imuniteti përballë ligjit. Po ashtu, shumë përfaqësues të PD, humbasin rroga, dieta dhe benefite të tjera që burojnë nga statusin e deputetit.

**DISA NGA TË DREJTAT DHE PRIVILEGJET QË HUMBET PD**

1. Partia Demokratike kthehet në një parti jo parlamentare.
2. PD humbet ligjërish statusin e opozitës shqiptare.
3. Në bazë të nenit 22 të ligjit për partitë politike, PD humbet selinë e saj, e quajtur ndryshe Shtëpia Qendrore e Ushtrisë.
4. Humbet prezencën mediave dhe zërin në foltoren e Parlamentit.
5. Humbet përfaqësimin me anëtarë në KQZ, KZAZ, Grupet e Numërimit dhe Qendrat e Votimit.
6. Humbet të drejtën për të ngritur komisione hetimore.
7. Humbet të drejtën për të vënë në lëvizjes Gjykatën Kushtetuese.
8. Humbet të drejtën për t'u përfaqësuar me anëtarë në nënkomisionet për të zgjedhur 10 anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
9. Humbet të drejtën për t'u përfaqësuar me anëtarë në komisionet që do zgjedhin anëtarët e organeve të Vetingut.
10. Nuk mund të bëhet pjesë e komisioneve për ndryshimin e Kodit Zgjedhor.
11. Nuk mund të kushtëzojë me votë shumicën e re për ndryshime të mundshme në Kushtetutë.
12. Humbet çdo mundësi për mocion mosbesimi ndaj qeverisë.
13. Duke humbur vendet në Parlament, për rrjedhojë përfaqësues të Partisë Demokratike nuk do të përfitojnë rroga, dieta dhe benefite që burojnë nga statusin e deputetit.
14. Kupola drejtuese e PD, duke mos qenë pjesë e parlamentit, humbet njëfarë imuniteti përballë ligjit.
15. Humbet përfaqësimin në delegacionet e përhershme parlamentare dhe grupet e miqësisë.
16. Humbet përfaqësimin në komisionet dhe organizmat e tjera parlamentare.
17. Humbet kontaktet me Parlamentin Evropian.
18. S'mund të konsiderohet më një alternativë për qeverisjen e vendit.
19. Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha humbet të drejtën për t'u ruajtur dhe mbrojtur nga Garda e Republikës.
20. PD nuk përfiton fonde vjetore nga buxheti i shtetit në bazë të numrit të votave në zgjedhjet e fundit parlamentare.

**NJOFTIM**

**II. SHOQËRIA PËRMBARIMORE "616/A" SHPALL PËR SHITJE PASURITË E PALUAJTSHME :**

1) Ndërtesë me sip. 285,6 m2, me nr. pasurie 3/504-N3, vol.39, faq.82, zona kadastrale nr. 8564 e ndodhur në rrugën "Viktimat e 7-Shkurtit" Korçë. Pasuria shpallet me vlerë fillestare me çmimin **9.093.600 lekë** ( Nëntëmiljon e nëntëdhjet e tre mijë e gjashtëqind).

2) Tokë Arë me sip. 7.000 m2, me nr. pasurie 137/1, vol.21, faq.82 e ndodhur në zonën kadastrale 8564, rruga "Viktimat e Ravonikut" mbrapa fabrikës së tullave, Korçë. Pasuria shpallet me vlerë fillestare me çmimin **2.408.000 lekë** ( Dymiljon e katërqind e tetë mijë).

**ANKANDI ZHVILLOHET DITËN E ENJTE NË DATË 04.05.2017**

Personat e interesuar mund të paraqiten në adresën Lagjia Nr.3, Rruga "Andon Xoxe", Pogradec ose të kontaktojnë në numrin 0662036006 ose në e-mail: shoqeria616a@gmail.com

# Ben Blushi dorëzon listën e kandidatëve, 164 emrat e LIBRA-s

## Deputeti Blushi dhe Hafizi kandidojnë në Tiranë, ja kush kryeson në të 12 qarqet

Partia Lista e Barabartë (LIBRA) ka dorëzuar mbrëmë listën me 164 kandidatë për deputetë për zgjedhjet e 18 Qershorit. Kreu i LIBRA-s Ben Blushi ia ka bashkangjitur listës së kandidatëve 10 mijë firmat e qytetarëve në Komisionin Qendror

të Zgjedhjeve. LIBRA dorëzoi listën e kandidatëve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në ditën e fundit të afatit për regjistrimin e kandidatëve për deputetë. Referuar listës, deputetët Ben Blushi dhe Mimoza Hafizi do të garojnë në zgjedhjet e qershorit në qarkun e Tiranës. Lista në Tiranë

**Tirana**  
Lista në Tiranë kryesohet nga Blushi, i ndjekur nga Hafizi, Aida Niço, Matilda Cara, Tomi Kallanxhi dhe Ardiana Çapi

kryesohet nga Blushi, i ndjekur nga Hafizi, Aida Niço, Matilda Cara, Tomi Kallanxhi dhe Ardiana Çapi. Në Berat, lista e kandidatëve për deputetë të LIBRA-s, Alma Larushi, në Dibër kryesor Arben Ismaili, në Durrës nga Rezart Kthupi, në Elbasan nga Mimoza Deliu, në Fier lista LIBRA kryesohet

nga Astrit Hysi, në Gjirokastrë nga Foto Vasili, në Korçë nga Sonila Boçi, në Kukës nga Fatmir Gjuta, në Lezhë nga Elida Hafizi, në Shkodër nga Violeta Alushi dhe në Vlorë nga Krenar Brahimmuço. Kjo do të jetë sfida e parë zgjedhore e partisë së drejtuar nga deputeti Ben Blushi. Bojkoti i

Partisë Demokratike favorizon partinë e ashtuquajtura të vogla në zgjedhjet e 18 Qershorit. Nëse Partia Demokratike do të konkretizojë bojkotin e zgjedhjeve, disa nga krerët e partive të vogla, ndonëse nuk favorizohen nga formula zgjedhore, mund të bëhen pjesë e Parlamentit të ri.



Ben Blushi dhe Mimoza Hafizi

### LISTA E KANDIDATEVE PER DEPUTET TE LIBRA

Nr në listë	Emri	Mbiemri
1	Alma	Larushi
2	Plarent	Aleks
3	Bruno	Qytyku
4	Vasiliqi	Germu
5	Aldi	Saraseli
6	Enxhi	Guri
7	Artjon	Koxhaj
8	Esjona	Asllanaj
9	Entilian	Gjata
<b>QARKU DIBER</b>		
1	Arben	Ismaili
2	Besjan	Elezi
3	Bleona	Hoxha
4	Olsion	Smeli
5	Alban	Çela
6	Urime	Straka
7	Emrije	Krosi
<b>QARKU DURRES</b>		
1	Rezart	Kthupi
2	Erida	Kabashi
3	Myslim	Gardhi
4	Florian	Nallbani
5	Andi	Piho
6	Higerta	Bali
7	Ervin	Halili
8	Keola	Selman
9	Florjana	Mazrreku
10	Arben	Shahini
11	Enea	Ndreu

Nr në listë	Emri	Mbiemri
12	Domeniko	Sinjari
13	Nelda	Nasho
14	Antonio	Cania
15	Bledi	Çadra
<b>QARKU ELBASAN</b>		
1	Mimoza	Deliu
2	Bujar	Kapllani
3	Indrit	Ago
4	Gazmend	Bylyku
5	Zhaneta	Tola
6	Gerant	Kollçaku
7	Silvana	Muça
8	Alajd	Alla
9	Durim	Karaj
10	Flutura	Shqau
11	Andi	Albrahimi
12	Aurela	Xhemalallari
13	Arlin	Jaupi
14	Armend	Krasniqi
15	Eldon	Leka
16	Klejda	Liçenji
<b>QARKU FIER</b>		
1	Astrit	Hysi
2	Ergest	Lekdushi
3	Mimoza	Leka
4	Admir	Iliazi
5	Artur	Gjika
6	Pranvera	Troka
7	Erson	Mata

Nr në listë	Emri	Mbiemri
8	Xhavit	Gjini
9	Flatun	Fatmiri
10	Suela	Hoxhaj
11	Daniel	Koçi
12	Gentjana	Hykaj
13	Arban	Zhuzhuni
14	Klevist	Dalipaj
15	Eliona	Semanjaku
16	Bektash	Gremi
17	Anila	Gjini
18	Ardit	Bufi
19	Ardjan	Jani
20	Kledi	Duraj
<b>QARKU GJIROKASTER</b>		
1	Foto	Vasili
2	Irena	Buxhuku
3	Gramoz	Mamaj
4	Merita	Alikaj
5	Mystehak	Muha
6	Lorenc	Jaupi
<b>QARKU KORÇE</b>		
1	Sonila	Boçi
2	Edi	Grabocka
3	Rinela	Prifti
4	Daniel	Shahollari
5	Neritan	Seferkolli
6	Urim	Bajraktari
7	Donaldi	Poloska
8	Albina	Frasheri

Nr në listë	Emri	Mbiemri
9	Klarita	Hyke
10	Romina	Gora
11	Agim	Kryemadhi
12	Anila	Malelli
13	Alije	Pilinci
<b>QARKU KUKES</b>		
1	Fatmir	Gjuta
2	Arbër	Laçi
3	Çiljeta	Hajdarmataj
<b>QARKU LEZHE</b>		
1	Elida	Hafizi
2	Pashko	Gjeta
3	Alda	Frokaj
4	Albert	Lleshi
5	Laureta	Kola
6	Gentjan	Marku
7	Erjona	Elezi
8	Edison	Gjeka
<b>QARKU SHKODER</b>		
1	Violeta	Alushi
2	Meridian	Ramcaj
3	Seat	Mushani
4	Vjollca	Vukzaj
5	Renato	Kaçi
6	Medina	Fusha
7	Kristian	Kota
8	Klaus	Boka
9	Albert	Ndoci
10	Besara	Gjurgje

Nr në listë	Emri	Mbiemri
11	Fatjon	Kraja
12	Erikond	Mardoda
13	Klodjana	Lasku
<b>QARKU TIRANE</b>		
1	Ben	Blushi
2	Mimoza	Hafizi
3	Aida	Niço
4	Matilda	Cara
5	Tomi	Kallanxhi
6	Ardiana	Çapi
7	Edrin	Gaxhenji
8	Flogerta	Beshiraj
9	Laureta	Alikaj
10	Bora	Xhanija
11	Edmond	Dymishaj
12	Petrit	Beqiri
13	Gjergj	Prifti
14	Kreshnik	Kolndreu
15	Entela	Kadriu
16	Albi	Sulo
17	Ismail	Topi
18	Matilda	Beqiri
19	Jak	Perpalaj
20	Lumturi	Papa
21	Merita	Shimaj
22	Dritan	Sterkaj
23	Olsi	Sherifi
24	Arber	Ndregjoni
25	Marion	Kazazi

Nr në listë	Emri	Mbiemri
26	Anila	Vogli
27	Vladimir	Lama
28	Eligert	Uzuni
29	Klodjan	Karaj
30	Ndue	Prela
31	Nevruz	Met-Hasani
32	Jurgen	Bajro
33	Nuri	Keça
34	Walter Borisovic	Kryemadhi
35	Klaudja	Resulaj
36	Xhuljano	Selami
37	Hamit	Koxha
38	Anisa	Memushi
39	Anila	Bacelli
40	Sokol	Rjepaj
41	Enkeled	Resulaj
<b>QARKU VLORE</b>		
1	Krenar	Brahimmuço
2	Aleksander	Vero
3	Anida	Dukaj
4	Drini	Brokaj
5	Gentian	Muçollari
6	Fatmir	Tozaj
7	Renato	Dhima
8	Everest	Grosler
9	Lindita	Çarçiu
10	Florjan	Gjoni
11	Marinela	Doko
12	Nevila	Alliaj
13	Xhilda	Koçiu

### ZGJEDHJET/ ISH-DEPUTETI I PD KANDIDON PËR PDIU

## PDIU dorëzon listat, Idrizi dhe Doda kandidojnë në Tiranë

E dhe PDIU ka dorëzuar listën e plotë të kandidatëve për deputetë në KQZ për zgjedhjet e 18 qershorit. Kryetari Shpëtim Idrizi dhe Mesila Doda kandidojnë në Qarkun e Tiranës. Në Elbasan listën e kryeson Aqif Rakipi, në Vlorë Tahir Muhedini, Nustret Avdulla në Fier, Krenar Lasko në Durrës, Reme Lala në Dibër, Fatos Hoxha në Kukës, biznesmeni Sait Fishta në Shkodër, Spartak Meraku në Korçë, Zef Doçi në Lezhë, Albano Idrizi në Berat dhe Lueda Sina në Gjirokastrë. Ndërkaq, bie në sy që ish-deputeti i Partisë Demokratike, Fatos Hoxha, kandidon për PDIU në Qarkun e Kukësit. Hoxha ka qenë mjaft kritik për mënyrën se si Lulzim Basha dhe Sali Berisha po e drejtojnë Partinë Demokratike.

LISTA E KANDIDATEVE PER DEPUTET TE PDIU				
<b>QARKU DIBER</b>				
Mesila Doda	Hekuran Halili	Reme Lala	Eva Çollaku	
Marinelo Rami	Anila Ahmataj	Lulzim Viçishta	Arbër Kulla	
Arjan Hamiti	<b>QARKU FIER</b>			
Alfred Deshati	Nustret Avdulla	Artan Bitri	<b>QARKU LEZHE</b>	
<b>QARKU ELBASAN</b>				
Aqif Rakipi	Ardian Sheme	Elisava Methasani	Zef Doçi	
Bujar Muça	Enisa Rexhepi	Fatos Hoxha	Vladimir Lleshaj	
Elena Xhina	Alfred Sulejmani	Everest Demushi	Estela Arapi	
Dritan Bici	Valentina Nuredini	Lirie Ahmeti	<b>QARKU BERAT</b>	
Servo Mehmeti	<b>QARKU DURRES</b>			
<b>QARKU VORE</b>				
Tahir Muhedini	Krenar Lasko	Sait Fishta	Albano Idrizi	
Arjol Shero	Altin Hoxha	Liljan Idrizaj	Sonila Zejenli	
Teuta Ramaj	Edlira Abdurrahmani	Edlira Ura	Klilton Lyla	
	Olta Nexhipi	<b>QARKU GJIROKASTER</b>		
	Arben Xhemali	Lueda Sina	Xhenet Sula	
	<b>QARKU DIBER</b>			Ilir Laze
	Brikena Zeneli	<b>QARKU KORÇE</b>		
		Spartak Meraku		
		Brikena Zeneli		



Shpëtim Idrizi dhe Mesila Doda

**Vettingu**

**Economist Intelligence Unit pret që reforma në sistemin e drejtësisë të përfundojë me sukses, madje me shumë gjasa brenda vitit në vazhdim**



**QEVERISJA**

Sipas EIU, koalicioni aktual qeverisës, me Partinë Socialiste dhe Lëvizjen Socialiste për Integrim, është në një pozicion të fortë për të mbajtur pushtetin pas zgjedhjeve të ardhshme të qershorit 2017

**EKONOMIA**

Rritja ekonomike në vitin 2016 ishte 3.2%. Ky vlerësim është më i ulët se ai i qeverisë dhe institucioneve shqiptare, por edhe FMN, apo BE, etj, të cilët për vitin 2016 kanë deklaruar rritjen prej 3.46%




**Integrimi**

**Pas reformës së sistemit të drejtësisë, Shqipëria do të marrë shpejt një ftesë për të hapur negociatat për anëtarësim në BE**

# “The Economist”: Reforma në drejtësi përfundon me sukses

Njësia e “zbulimit” e revistës prestigjioze, optimiste për perspektivat e Shqipërisë

**E**conomist Intelligence Unit (EIU), një njësi e “zbulimit” e revistës prestigjioze “The Economist”, në raportin për tremujorin e parë 2017 për Shqipërinë ka dhënë një prognozë pozitive, jo vetëm për ekonominë e vendit, por kryesisht edhe për situatën politike. Analistët e EIU vlerësojnë se koalicioni aktual qeverisës, që përbëhet nga Partia Socialiste dhe Lëvizja Socialiste për Integrim, është në një pozicion të fortë për të mbajtur pushtetin pas zgjedhjeve të ardhshme të qershorit 2017. Duket që kjo analizë është bërë para se të përfundonte afati i regjistrimit në KQZ të koalicioneve, por ndoshta ajo merr në konsideratë një bashkëpunim të ardhshëm paszgjedhor midis dy forcave të majta politike shqiptare. Nga ana tjetër, “The Economist” nuk mungon ta vejë theksin edhe në perspektivën e reformave të ndërmarra nga shteti shqiptar. Kështu, Economist Intelligence Unit pret që reforma në drejtësi të përfundojë me sukses, madje me shumë gjasa brenda vitit në vazhdim. “Pas reformës së sistemit të drejtësisë, Shqipëria do të marrë shpejt një ftesë për të hapur negociatat për anëtarësim në Bashkimin Europian, por kjo nuk pritet të ndodhë para fundit të vitit 2017, ose edhe më vonë se kaq”. Por EIU beson se qeveria, gjatë një periudhe të shkurtër kohore do të pezullojë konsolidimin fiskal. Kjo lidhet me periudhën përpara zgjedhjeve parlamentare, çka është bërë tashmë traditë nga të gjitha qeveritë shqiptare, megjithatë ajo do të vazhdojë të nxisë rritjen ekonomike.



**EKONOMIA**

Natyrshik, vëmendja kryesore e raportit të Inteligjencës i kushtohet situatës në ekonominë shqiptare. Sipas raportit, rritja ekonomike në

vitin 2016 është përsheptuar në 3.2%. Ky vlerësim, në fakt, është më i ulët se ai i qeverisë dhe institucioneve shqiptare, por edhe FMN, apo BE, etj, të cilët për vitin

2016 kanë deklaruar rritjen prej 3.46%. Ndërkohë, për vitin 2017, EIU pret që rritja të përsheptohet në 3.5%, si rrjedhojë e interesave më të ulta të borxhit publik dhe përmirësimit të

aktivitetit të brendshëm, tendencë kjo, që do të vijontenë vitin 2018 në 3.6%. EIU pret që inflacioni të rritet në muajt e ardhshëm, si rezultat i një kombinimi të çmimeve më të larta ndërkombëtare të energjisë dhe rritjes së kostove të importit, duke reflektuar pasojat e një dollari më të rëvlerësuar amerikan dhe një rritje në kërkesën e brendshme. Rritja e pensioneve dhe pagave të sektorit publik, si dhe rritja e pagave minimale përpara zgjedhjeve të ardhshme parlamentare, do të përforcojnë presionet inflacioniste. Si rezultat i këtyre zhvillimeve, EIU parashikon që në vitin 2017, inflacioni mesatar do të kthehet qendrueshëm brenda intervalit të synuar të BSH, për herë të parë që nga viti 2012. Në krahasim me raportin e kaluar, EIU ka rritur parashikimin për inflacionin, nga 2.3%, në 2.6%. Kufijtë e preferuar nga Banka e Shqipërisë për këtë tregues janë nga 2 deri në 4 për qind. Sipas analistëve, deficit i llogarisë korente të Shqipërisë pritet të zgjerohet më tej, në 12% të PBB-së në 2016, nga 10.7% në vitin 2015, kjo, si rrjedhojë e rritjes së importeve. Po kështu, EIU mban parashikimin që në 2017-n ky deficit do të zgjerohet edhe më tej, në 12.6% të PBB-së, teksa çmimet e naftës do të rimëkëmben. Duke pasur parasysh të dhënat më të fundit mbi performancën fiskale, EIU mban parashikimin se deficit i buxhetor në vitin 2017 do të ndryshojë pak, në 2.4% të PBB-së, përpara se konsolidimi fiskal të rifillojë në 2018, duke e ngushtuar deficitin buxhetor në 1.4% të PBB-së. Shifra këto jashtëzakonisht të lakmueshme për të ulur borxhin e lartë publik të vendit.

**PROCEDURAT/ DO TË VLERËSOHEN ME METODA ALTERNATIVE**

# Kujtesë për dorëzimin e deklaratave tatimore

**Pas 30 ditësh, do të mblidhet detyrimi nga subjektet me forcë**

**T**atimet kanë njoftuar bizneset se, kur tatimpaguesi nuk dorëzon në afat një deklaratë tatimore, atëherë ai fillimisht do të njoftohet nga Tatimet për mospërbushjen e këtij detyrimi brenda pesë ditësh. Nëse brenda 10 ditëve tatimpaguesi ende nuk e kanë bërë deklarinimin, administrata do të bëjë një vlerësim të detyrimeve tatimore të tatimpaguesit, sipas njëres prej metodave alternative. Në fakt, do të zbatohet një procedurë e përcaktuar në nenin 71/1 të ligjit nr.9920 datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Sipas këtij neni, në çdo rast kur një tatimpagues nuk ka dorëzuar



Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

deklaratën/deklaratat e tij tatimore, për një periudhë tatimore, ai njoftohet nga ana e administratës tatimore me anë të dokumentit “Letër Kujtesë”, për mos përmbushjen e këtij detyrimi. Sistemi informatik do të nxjerrë një Njoftim Vlerësimi tatimor nga zyra, i cili i njoftohet automatikisht tatimpaguesit. Ky Njoftim Vlerësimi nuk mund të ankimohej në Drejtorinë e Apelitit Tatimor, në rrugën e ankimit të akteve administrative tatimore. Tatimpaguesi ka të drejtë, që me marrjen e “Njoftim Vlerësimi” të bërë nga ana e administratës tatimore, sipas parashikimit të kësaj pike, të paraqesë deklaratën e tij tatimore.

Vetëm në rastin e paraqitjes së deklaratës tatimore të padorëzuar më pare, me t'u bërë ky deklarim, automatikisht anulohet vlerësimi i detyrimit tatimor të bërë nga zyra prej administratës tatimore. Tatimet parajmërojnë subjektet të jenë të kujdesshëm, pasi, nëse nga ana e tatimpaguesit, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftim-vlerësimit tatimor nga zyra, nuk është dorëzuar deklarata tatimore ose nuk është paguar shumata e detyrimit lidhur me të, administrata tatimore fillon procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore. Kjo procedurë ndiqet për çdo lloj deklarate tatimore e çdo tatimi lidhur me të.

## I FORTI I "MYSLYM SHYRIT"

ELTON QYNO  
TIRANE

**G**jergji Cukali, i cilësuar si i forti i rrugës "Myslym Shyri" është marrë i pandehur së bashku me 5 persona të tjerë, si person që drejtonte një grup që shpërndante kokainë në zona të ndryshme të Tiranës. Hetimet e prokurorisë, kanë zbuluar se Cukali ishte drejtuesi i këtij grupi, ndërkohë që gjatë hetimeve ai ka rënë në dijeni të ndjekjes nga policia, dhe për pasojë i ka kërkuar një shoku të tij, që ti bëjë një shërbim. Cukali ka marrë në kontakt me shtetasin Artur Tarja, të cilit i kërkon që të shkojë deri tek kryqëzimi i "21 dhejtori", për të takuar dikë në vendin ku bëhen Çelësat. Në fakt Tarja ka zhvilluar një takim me një person të panjohur pikërisht në këtë vend, nga ku ka marrë informacion se Cukali dhe grupi i tij ishte në mbikqyrje të plotë dhe se ai do bënte diçka. Mirëpo Cukali ka kërkuar të dinte se sa ishte kafja e kësaj pune, por Tarja nga ana tjetër i ka sugjerur se personi që kishte takuar tek Çelësat, do i kthente një përgjigje në një moment të dytë. Më tej Tarja, i thotë Cukalit që të mos flasë me askënd dhe duhet të qëndrojë nga 10 ditë i izoluar duke mos dalë në rrugë. Kjo bisedë tregon se ata ishin vënë në dijeni të një arrestimi të mundshëm ndaj duhet të qëndronin në heshtje. Mirëpo frika e policisë dhe prokurorisë se Cukali mund të zhduej duke ju shmangur policisë, ka sjellë reagimin e menjëhershëm duke organizuar operacionin "Tangent" dhe arrestuar Cukalin dhe bashkëpunorët e tij, mes të cilëve dhe një femër që ishte financierja e grupit.

## BISEDA PËR NJË BORSX FINANCIAR

Nga interceptimet telefonike u konstatua se shtetasi Gentian Balliu lëndën narkotike të llojit kokainë e siguron tek shtetasi Gjergji Cukali. Në një bisedë të 22 majit 2016 me numrin telefonik 069340XXX në përdoim nga shtetasi Gjergji Cukali i dërgon sms numrit telefonik 06952XXX në përdorim nga shtetasi Gentian Balliu me përmbajtje: "...Me kishë 2700, me dhe një pa dhjet mijë dhe ke dhe 1700 tani dhe atë 230 të ati shokut ok...". Po nga interceptimet telefonike rezultoi se shtetasi Jurgen Hoxha, tashmë i arrestuar për shitjen e lëndës narkotike të llojit kokainë bashkëpunon me një person i identifikuar nga përgjimi me emrin Saimir. Ndërsa, shtetasi Kataldio Lezhja për shitjen e lëndës narkotike bashkëpunon ngushtë me një person të cilin e thërrasin me pseudonimin "Çerri" dhe "Rike". Gjithashtu nga interceptimet telefonike rezultoi se shtetasi Gjergji Cukali ka përdorur për kryerjen e veprimeve në aktivitetin e tij kriminal shtetasin Artur Tarja me numër telefoni 06998XXXX i cili mban lidhje dhe me shtetasin Gentian Balliu, ku në disa biseda telefonike i



Gjergji Cukali



Karta ID e Gjergji Cukalit me emrin Ergi Hoxha

## → FALSIFIKIMI

Nga akti i ekspertimit teknik për këto dokumente, u provua se leja e drejtimit dhe karta e identitetit janë tërësisht të falsifikuara, ndërsa pasaporta biometrike është e falsifikuar


# Dosja e Gjergji Cukalit në gjyq, ja si i forti nuhati se po ndiqej

## Cukali dhe 5 anëtarët e grupit të tij akuza për shpërndarjen e kokainë në Tiranë

kërkon lekët që ky i fundit i ka borxh shtetasit Gjergji Cukali me pseudonimin "LASHI". Si rezultat i ketyre përgjimeve dhe dokumentuar me anë të vëzhgimeve, në datë 27 prill 2016 u bë kapja në flagrancë dhe arrestimi i shtetasve Agron Mulolli dhe Jeta Blakcorri me sasinë prej 25.8 gramë lëndë e dyshuar narkotike e llojit kokainë, të cilët e blenë tek shtetasi Gjergji Cukali, pasi u takuan me këtë shtetas tek karburant "Elda" ne Laprakë, ku ndodhej shtetasi Agron Mulolli me mjetin BMË ngjyre gri me targe KSO1656FL dhe aty erdhi shtetasi Gjergji Cukali me motor të zi "T Max" me targe AN090.

## DROGA NË MBATHJE

Në datë 4 qershor 2016 u bë e mundur kapja në flagrancë dhe arrestimi i shtetasve Argers Sedo dhe Grigori Çina me sasinë prej 30.6 gramë lëndë e dyshuar narkotike e llojit kokainë, të cilët e blenë tek shtetasi Gjergji Cukali, pasi u takuan brenda në mjetin e këtij të fundit "Citroen" me targë AA260BT në rrugën "Budi" në afërsi të "Big Market". Konkretisht, shtetasit Argers Sedo ju gjet në të brendshmet e tij një paketim me lëndë pluhuri, qarkuar me natëban ngjyre kafe me mbishkrim me ngjyrë të zezë "25". Ndërkohë në datën 23 qershor 2016 u bë e mundur kapja në flagrancë dhe arrestimi i shtetasit Maringlen Jazaj me sasinë prej 0.4 gramë lëndë e dyshuar narkotike e llojit kokainë, të cilën e kishte blerë tek shtetasi Jurgen Hoxha, si dhe arrestimi i shtetasit Jurgen Hoxha me sasinë prej 14.4 gramë lëndë e dyshuar narkotike e llojit kokainë, të cilën e kishin blerë



Gentian Balliu



Artur Tare

## TE PANDEHUR

## GJERGJI CUKALI

"Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", në bashkëpunim.  
"Falsifikimi i pasaportave, leternjoftimeve apo l vizave"  
"Falsifikimi i dokumenteve"

## GENTIAN BALLIU

"Prodhimi dhe shitja e narkotikëve" në bashkëpunim

## ARTUR TARJA

"Prodhimi dhe shitja e narkotikëve" në bashkëpunim

## KRISALD KUNDRAXHI

"Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", në bashkëpunim

## VJOLLCA GJOKA

"Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", në bashkëpunim

## ARMANDO GJOKA

"Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", në bashkëpunim

tek shtetasi Hamdi Tallushi. Po në datën 23 qershor 2016 u kap në flagrancë dhe u bë arrestimi i shtetasve Hamdi Tallushi dhe Andi Tallushi me sasinë prej 116 gramë lëndë e dyshuar narkotike e llojit kokainë dhe 2 gramë bime e dyshuar Cannabis Sattiva.

## CUKALI PIKAS PËRGJIMIN DHE NDJEKJEN E POLICË

Për shkak të kësaj veprimtarie,

shtetasi Gjergji Cukali, në datën 29 qershor 2016 në orët e vona të mbrëmjes ka dyshuar se mund të jetë në përgjim telefonik, pas telefonatës dhe takimit me shtetasin e njohur me emrin Rrem Kallushi. Menjëherë pas takimit ka fikur numrin e telefonit 069 34XXXX dhe ju ka dërguar disa sms disa lidhjeve të tij shoqërore me numrin e telefonit tjetër 069 44XXXX ku ju thotë se "...Lashi jam, ky është numri im tani...". Në datë 2 korrik 2016 shtetasi Gjergji Cukali i ka telefonuar shtetasit Artur Tarja, bisedë me përmbajtje: "...Ku je të takosh njërin për punën time..., ndërkohë që Tarja ia kthen "...po ha bukë...". Më pas Cukali i thotë sërisht "...mirë mbaro bukën shpejtë dhe ik telefono këtë numër, dhe i jep një numër telefoni) dhe do të takohesh ku bëhen çelsat tek 21-shi Ok...". Pas 10 minutash shtetasi Artur Tarja telefonon subjektin Gjergji Cukali bisedë me përmbajtje: "...Ka folë dhe "OK" do ja bëj.... po do i thotë ky tani sa është kafja.... do na kthej përgjigje ky... dhe mos fol me asnjë fare dhe mos dil për një 10 ditë". Pas këtyre bisedave shtetasi Gjergji Cukali ka vendosur numër të ri telefonik që është 069 53 XXXX. Duke qenë se ky shtetas dyshohet për këtë veprë penale, ai u ndalua në datën 11 korrik 2016, duke menduar rrezikun e ikjes së këtij shtetasi dhe atë të ardhjes në dijeni të procedimit

penal. Pas ndalimit në banesën e shtetasit Gjergji Cukali, u gjetën sende që mund të kenë lidhje me veprën penale, si telefona celulare dhe një peshore elektronike që dyshohet të ketë lidhje me peshimin e lëndës narkotike. Gjithashtu u gjetën edhe dokumente me fotografiminë e shtetasit Gjergji Cukali, por me gjeneralitete të një shtetasi tjetër. Në datën 1 korrik 2016, në banesën e të pandehurit Gjergji Cukali u gjetën sende që mund të kenë lidhje me veprën penale, si telefona celulare dhe një peshore elektronike që dyshohet të kishte lidhje me peshimin e lëndës narkotike.

## CUKALI ME PASAPORTË ME EMRIN "ERGI HOXHA"

Gjithashtu, në banesën e të pandehurit Gjergji Cukali u gjetën një pasaportë biometrike, një kartë identiteti dhe një leje drejtimi me nr. TR025327/191209052K, të treja me të dhënat e shtetasit të quajtur Ergi Hoxha dhe me fotografiminë e të pandehurit Gjergji Cukali. Nga akti i ekspertimit teknik për këto dokumente, u provua se leja e drejtimit dhe karta e identitetit janë tërësisht të falsifikuara, ndërsa pasaporta biometrike është e falsifikuar, duke i ndryshuar fotografiminë dhe duke i hequr fletën origjinale dhe zëvendësimin e tyre me një fletë të një pasaportë tjetër e më pas qepjen e fletëve të bllokut të pasaportës. Edhe vulat e vendosura e këtë pasaportë të PKK Kakavijë janë të falsifikuara.

## ARRESTIMI I JURGEN HOXHËS



Vjollca Gjoka



Krisald Kundraxhi



Armand Gjoka

Në datë 23 qershor 2016 u bë e mundur kapja në flagrancë dhe arrestimi i shtetasit Maringlen Jazaj me sasinë prej 0.4 gramë lëndë narkotike e llojit kokainë, provuar nga akti i ekspertimit kimik, të cilën e kishte blerë tek i pandehuri Jurgen Hoxha, si dhe arrestimi i të pandehurit Jurgen Hoxha me sasinë prej 14.4 gramë lëndë narkotike e llojit kokainë, të cilën e kishte marrë nga i pandehuri Hamdi Tallushi. I pandehuri Jurgen Hoxha u kap në ambientet e bar kafe "Soba", ku në xhepin e pantallonave të shkurtëra të tij u gjet një qese ngjyre e bardhë e mbyllur me djegie, ku brenda saj kishte pluhur me ngjyrë të bardhë e llojit të lëndës narkotike kokainë. Ndërsa, në banesën e të pandehurit Jurgen Hoxha janë sekuestruar 3 doza të tjera me pluhur ngjyrë të bardhë e llojit të lëndës narkotike kokainë të futura në një objekt metalik në formë cilindri, një kartpicetë letre e mbështjellë, ku brenda saj ndodhej një qese transparente boshe dhe një qese tjetër e pa mbyllur me ngjyre të bardhë dhe blu ne vishnje, ku brenda saj kishte pluhur te bardhe e llojit kokainë.

# Skrapar, bllokohen 1.5 tonë drogë në tre banesa e rrugë

Në kërkim 3 persona, 6 shoqërohen. Para 1 muaj u zbulua laborator

**P**olicia ka sekuestruar një tjetër sasi të madhe lëndë narkotike, 1.5 ton kanabis në 3 banesa dhe në rrugën nacionale Poliçan-Bogovë. Deri tani janë shoqëruar 6 persona, ndërsa 3 të tjerë janë shpallur në kërkim, operacioni është zhvilluar në fshatin Përparim dhe në rrugën nacionale Poliçan-Bogovë. Sipas policisë operacioni është zhvilluar pas informacioneve në rrugë operative se në fshatin Përparim disa persona po kryenin aktivitetin e paligjshëm të transportit të narkotikëve. Në banesën e parë është gjetur një kamionçinë e ngarkuar plot me thasë me lëndë narkotike. Ndërkohë në banesën e dytë janë gjetur rreth 50 thasë me lëndë narkotike. Gjithashtu në banesën e tretë rreth 15 kg lëndë narkotike. Po kështu në rrugën nacionale Skrapar-Bogovë rreth 133 thasë me lëndë narkotike. Paraprakisht flitet se sasia mund të jetë më e madhe se 1.5 ton, mund të

## BIZNESMENIA

**Edlira Lame, tregtarja 42-vjeçare e arrestuar në këtë operacion dyshohet nga prokuroria se ka vënë në shërbim të trafikantëve, ambjentet e magazinave të saj,**

arrijë dhe rreth 2 ton. Në më pak se një muaj sasia e kanabisit të sekuestruar në zonën e Beratit dhe Skraparit arrin në 6 tonë, ndërsa sipas hetimeve të policisë trafikantët po tentonin të largonin drogën nga banesat e tyre për një vend më të sigurt.

## U KAP GRUAJA E ISH-KRYEBASHKIAKUT

Magazina në Skrapar ku sipas prokurorisë së Krimeve të Rënda u zbuluan, 2 mijë rënjë kanabis dhe një laborator droge, administrohej nga ish-kryebashkiaku i Çor-

ovodës Leter Lame, i cili ka ndëruar jetë në vitin 2010. Edlira Lame, e arrestuar tre ditë më parë dhe e lënë tashmë në burg nga Gjykata e Krimeve të Rënda, është bashkëshortja e ish-kryebashkiakut të Çorovodës. Pas vdekjes së burrit, magazina ku përpunoheshin bime medicinale është marrë në administrim nga Edlira Lame, e cila kishte futur në magazinë prodhimin e rakisë së Skraparit dhe paketimin e çantave të letrës. Gjatë operacionit policor fakti se magazina ka qënë dikur në administrim të ish-kryebashkiakut të LSI në Çorovodë dhe të një shtetasi Italian, është fshehur nga organet hetimore. Pavarësisht kësaj prokuroria thotë se ka sekuestruar dhe një sasi të konsiderueshme droge në ambjentet e kësaj magazine, por pa përcaktuar sasinë ekzakte të mallit të sekuestruar. Nga ana tjetër avokatët mbrojtës të Edlira Lames thanë se në ambjentet që administrohen nga



Droga e sekuestruar nga policia

Lame, nuk është gjetur asnjë sasi droge, por vetëm Raki, Verë dhe çanta kartoni. Para gjykatës, avokatët thanë se nuk janë sekuestruar 2 mijë rënjë kanabis në magazinë.

## "AMBJENTIN E KISHIM BRAKTISUR"

Edlira Lame mohoi në Gjykatën e Krimeve të Rënda të kishte dijeni për sasinë e madhe të drogës së zbuluar. Gruaja e cila akuzohet për trafik droge të mbetur në tentativë, përmes avokatit të saj, i tha Gjykatës se ajo nuk kishte në administrim magazinën ku u gjet droga, por një tjetër ambient pranë saj, ku

prodhoheshin verë, raki, si dhe çanta kartoni ambalazhi. Për të provuar alibinë, ajo paraqiti në Gjykatë një mandat pagese me vlerë 20 mijë dollarë nga një kompani amerikane, të cilën e kishte furnizuar me raki. Duke iu referuar magazinës ku u zbulua droga, Edlira Lame tha se atë e ka pasur në administrim një shtetas i huaj dhe bashkëshorti i saj, i cili ka ndërruar jetë pesë vite më parë. Gruaja ka shpjeguar se asokohe në magazinë kishin ngritur një biznes bimësh medicinale, por pas vdekjes së bashkëshortit, ishin tërhequr dhe ambienti ishte i braktisur.

## POLICIA

**Masat antikanabis, "blindohet" kufiri, shtohen qentë antidrogë**



Masat antikanabis blindojnë pikat kufitare në vend ndërsa nga java e ardhshme Policia e Shtetit do të shtojë qentë antidrogë dhe efektivët e policisë kufitare. Burime bënë me dije se me një urdhër të brendshëm të drejtorit të Policisë Haki Cako është vendosur që çdo mjet transporti mallrash dhe autobus të kalojë në skaner në pikat kufitare Durrës, Kakavijë e Kapshticë. Masat antikanabis prekin dhe automjetet e transportit personal, ku veturat që qarkullojnë me itinerar hyrës apo dalës nga Shqipëria do t'i nënshtrohen kontrollit me qen antidrogë dhe kamerë sinjalizuese për drogën në sebratorët e karburantit. Sipas urdhrat, sqaruan burimet janë 10 qenë antidrogë që i shtohen policisë kufitare e kryesisht do të përqendrohen në portin e Durrësit, kufirin me Greqinë dhe Malin e Zi. Këto masa, sipas urdhrat të drejtorit Haki Cako vijjnë në prag dhe të sezonit turistik ku pritet që policia kufitare të përballlet me një fluks të shtuar lëvizjesh si në mjete, qytetar dhe turist. Prej më shumë se një jave, fluksi i sasive të narkotikëve të sekuestruara në pikat kufitare është ulur ndjeshëm ndërsa Policia e Shtetit e kontaktuar nga Report Tv sqaron se kjo gjendje kontrolli e konsideruar niveli i kuq do të vazhdojë deri në muajin shtator.

## NGJARJA NË SHKODËR / SHPALLET NË KËRKIM KRYEPLAKU I FSHATIT PLAN

# Asgjësohen 502 fidanë kanabis, 3 të arrestuar

**A**sgjësohen 502 fidanë kanabis dhe rreth 2,5 kg kanabis, arrestohen 3 persona, procedohet penalisht në gjendje të lirë Administratori i Njësisë Administrative Pult, shpallet në kërkim kryeplaku i fshatit Plan. Më datë 28 prill 2017, nga shërbimet e Komisarariatit të Policisë Shkodër, u finalizua me sukses operacioni i koduar "TEBREG", ku mbi bazën e



informacioneve të marra në rrugë operative, është ushtruar kontrolli territori në Njësinë Administrative Pult, fshati Plan, në lagjen Tebreg dhe në territorin përreth. Si rezultat i operacionit u bë arrestimi i Marash Mani, 74 vjeç, Tomë Kronajt, 72 vjeç, Lonard Kronaj, 21 vjeç, të tre banues në fshatin Plan, Shkodër. Nga kontrolli i ushtruar në afërsi të banesave së shtetasve Tom

Kronaj dhe Marash Mani, janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale, 2 qese plastmase ku brenda tyre kishte kanabis me peshë rreth 2.5 kg, si dhe në faqen e kodrës pranë këtyre banesave janë gjetur dhe asgjësuar me zjarr, 402 fidanë dhe 80 rënjë bimë narkotike e llojit Cannabis Sativa. Në lidhje me këtë rast, është proceduar në gjendje të lirë për veprën penale "Moskallëzim i

krimit", e parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal, T. M, 61 vjeç, banues në lagjen "Skënderbeg" Shkodër, me detyrë administratori i Njësisë Administrative Pult, Shkodër. Si dhe u bë shpallja në kërkim policor për P. Rr, 43 vjeç, banues në fshatin Plan, Shkodër, me detyrë kryeplak në fshatin Plan, për veprën penale "Moskallëzim i krimin", e parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal.

## NGJARJA NË DURRËS

**Sekuestrohet 20 kg kanabis pranë bregdetit**



**P**olicia ka sekuestruar një thes me 20 kg kanabis, ndërsa po punohet për identifikimin dhe arrestimin e poseduesit. Sipas policisë, rreth orës 16:30 gjatë kontrollit të ushtruar vijës bregdetare, në afërsi të Kallmit është gjetur thesi me 20 kg kanabis. Specialistët për Hetimin e Narkotikëve vijnë punën për kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale.

## OFERTË PUNËSIMI

Kompania mediatike Shqiptarja.com kërkon të punësojë agjent marketingu që plotëson kriteret e mëposhtme:

TË KETË ARSIM TË LARTË

TË KETË PËRVOJË PUNE

TË JETË I GATSHËM PËR TË PUNUAR NË TERREN

PERSONAT E INTERESUAR TË DËRGOJNË CV E TYRE NË ADRESËN:  
marketing@shqiptarja.com

## KAMIONI ME DROGË

**Një ton kanabis, në burg doganieri e policët**

**G**jkata e Krimeve të Rënda ka lënë në fuqi masat "arrest me burg" për 1 doganier, 3 efektivët e policisë dhe shoferin e përfshirë në trafikun e 1 kanabis drejt Greqisë në shkurt 2017. Hetimet e prokurorisë zbardhën se Ylli Rustemi, doganier në Kakavi, Vladimir Skrapalliu, Blerim Mëhilli, Klement Budo, lejuan shoferin Qamil Mucaj të kalonte drogën duke mos i kontrolluar kamionin me qen antidrogë dhe duke mos e peshuar. Shoferi Mucaj ende nuk është arrestuar ndërsa ai kërkohet dhe nga policia Greke për përfshirje në trafikun e narkotikëve.

# Koreja e Veriut teston tjetër raketë bërthamore

## Prova dështoi, por merret si një kokëfortësi e regjimit ndaj amerikanëve

**K**oreja e Veriut ka testuar në orët e para të së shtunës (ora lokale koreane), një tjetër raketë balistike. Këtë lajm e ka konfirmuar ushtria koreano-jugore, për agjencinë e lajmeve Yonhap, ndërkohë që ende nuk dihet lloji i raketës së hedhur dhe se sa larg ka fluturuar ajo. "Raketa balistike është hedhur nga Pyeongani Jugor", thotë drejtuesit ushtarakë të Koresë së Jugut, ndërsa nga Koreja e Veriut nuk ka ende asnjë prononcim në lidhje me këtë test të radhës.

Një burim i qeverisë amerikane, i ka thënë agjencisë Reuters se testi ka rezultuar i pasuksesshëm.

Ky test vjen pak orë pasi Sekretari amerikan i shtetit, Rex Tillerson i bëri thirrje shteteve të tjera, që të kontribuojnë për të detyruar Korenë e Veriut, të heqë dorë nga ambicet e saj bërthamore. Tensionet në rajon janë rritur ndjeshëm, ndërkohë që një javë më parë, Koreja e Veriut kreu një tjetër test, i cili dështoi që në nisje. Sekretari amerikan i Shtetit, Rex Tillerson deklaroi të premten se Shtetet e Bashkuara po i mbajnë "të gjitha opsionet" mbi tryezë, nëse diplomacia dështon të detyrojë Korenë e Veriut të ndalë programin bërthamor.

Duke folur në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, Tillerson bëri thirrje për sanksione të

dhimbshme ndërkombëtare kundër Koresë së Veriut, si dhe kërcënoi se do të vendosë sanksione edhe ndaj palëve të treta, që vazhdojnë të bashkëpunojnë me vendin e izoluar komunist. Ai kërkoi gjithashtu që Koreja e Veriut të heqë dorë nga programi i armëve bërthamore, përpara se të nisnin bisedimet me të. "Sa më shumë e çojmë dem kohën tonë, aq më shpejt do të mbetemi pa mundësi për të reaguar, - tha Tillerson. - Të gjitha opsionet e reagimit tonë ndaj provokimeve të ardhshme duhet të mbeten mbi tryezë".

Kryediplomati amerikan shtoi se "Koreja e Veriut duhet të ndërmarrë hapa konkretë për të reduktuar kërcënimin që përbën programi i saj i paligjshëm i armëve ndaj Shteteve të Bashkuara apo aleatëve tanë, përpara se ne të konsiderojmë dialogun".

Fjalimi i Tillerson ishte i pari i tij përpara Kombeve të Bashkuara dhe përfaqëson një vëmendje të përshkallëzuar nga administrata e Trumpit përkundëjt kërcëni-

### Thirrja

Ky test vjen pak orë pasi Sekretari amerikan i shtetit, Rex Tillerson i bëri thirrje shteteve të tjera, që të kontribuojnë për të detyruar Korenë e Veriut, të heqë dorë nga ambicet e saj bërthamore

### Kina

Kina, gjithsesi, ka këmbëngulur për atë që ajo e quan si një "qasje paralele", duke u bërë thirrje Shteteve të Bashkuara të ndalojnë përgatitjet ushtarake dhe praninë e tyre në gadishullin Korean

meve bërthamore dhe të raketave balistike të Koresë së Veriut.

Kina, gjithsesi, ka këmbëngulur për atë që ajo e quan si një "qasje paralele", duke u bërë thirrje Shteteve të Bashkuara të ndalojnë përgatitjet ushtarake dhe praninë e tyre në gadishullin korean, në këmbim të pezullimit të testeve raketore të Koresë së Veriut. Kjo e fundit është vënë prej kohësh nën sanksione të ashpër të Këshillit të Sigurimit, por pavarësisht atyre, Peniani vazhdimisht i ka shkelur konventat ndërkombëtare.

bëtare.

Shtetet e Bashkuara e kanë refuzuar deri më tani planin e Kinës, ndërsa as Koreja e Veriut nuk e ka pranuar atë. Ministri i Jashtëm kinez, Wang Yi bëri thirrje për pezullimin e stervitjeve të përbashkëta ushtarake mes SHBA-ve dhe Koresë së Jugut, e ka paralajmëruar kundër "retorikave apo veprimeve provokuese".

Ai doli gjithashtu kundër linjës amerikane se, Kina është ajo që mban "çelësat" për të detyruar Korenë e Veriut të pezullojë programin bërthamor të saj. Gjithsesi, ai



shtoi se rifillimi i bisedimeve mund të ulë tensionet mbi kërcënimin bërthamor, duke theksuar se që kur bisedimet u ndërpre, Koreja e Veriut ka përsëlluar testet e saj bërthamore.

Ndërkohë, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Antonio Guterres, i thirrur nga Tillerson për të dhënë informacione mbi situatën në gadishullin korean përpara se të flisnin ministrat e tjerë, tha se "mungesa e kanaleve të komunikimit me DPRK-në është e rrezikshme", duke përmendur këtu akronimin e Republikës Demokratike Popullore të Koresë (Koreja e Veriut). "Ne duhet të veprojmë tani!", ishte mesazhi i Guterres.

### VIZITA

#### Papa Françesku mbërrin në Kajro takon imamët

Gjatë vizitës së tij dyditore në Egjipt, Papa Françesku u ka bërë thirrje udhëheqësve myslimanë të vendit që të bashkohen në refuzimin e ekstremizmit të dhunshëm, në një kohë kur militantët islamikë po shënjestrojnë komunitetet e krishtera anembanë Lindjes së Mesme. Udhëtimi i Atit të Shenjtë, që ka për synim të përmirësimit marrëdhëniet kristiano-myslimane, vjen vetëm 3 javë pasi kamikazë të Shtetit Islamik vranë të paktën 45 persona në dy kisha egjiptiane. "Le t'i themi edhe njëherë me vendosmëri dhe qartësi 'Jo' çdo lloj dhune, hakmarrjeje apo urrejtjeje të ndërmarrë në emër të një besimi fetar apo në emër të Zotit", tha Papa Françesku në një konferencë paqeje të mbajtur në autoritetin më të lartë islamik të Egjiptit, Al-Azhar. "Të gjithë bashkë le të pohojmë papajtueshmërinë e dhunës me besimit, besimit dhe urrejtjes", tha ai në selinë 1000-vjeçare të myslimanëve sunitë. Papa Françesku u takua menjëherë me presidentin egjiptian, Abdel Fattah al-Sisi, sapo zbriti në Kajro, duke lëvizur nëpër rrugët e mbipopulluara dhe nën siguri të rreptë, por duke refuzuar sërish autokolonën e blinduar e duke përdorur automjetin normal pa xhama mbrojtës.

### VENEZUELA

#### Opozita kërkon zgjedhje të parakohshme

Lideri i opozitës në Venezuelë Henrique Capriles deklaroi për BBC se zgjedhjet e parakohshme janë mënyra e vetme për t'i dhënë fund krizës në vend. Capriles akuzoi presidentin Nikolas Maduro se po shtyp në mënyrë mizore popullin venezuelian. Zgjedhjet presidenciale në Venezuelë janë në fund të 2018-s, por opozita kërkon zhvillimin e tyre sa më shpejt, pasi fajësojnë presidentin socialist për krizën politike dhe ekonomike në vend. Rreth 30 persona janë vrarë në Venezuelë gjatë protestave të dhunshme të këtij muaji, ndërsa ekonomia është në kolaps të plotë.

### DYSHIMI/ STAFI I MACRON ËSHTË SULMUAR NGA HAKERA RUSË

## SHBA: Kujdes nga ndërhyrja ruse në zgjedhjet franceze

**P**aralajmërimi ka ardhur nga përtej Atlantikut muajin e kaluar. Richard Burr, shefi i komitetit të inteligjencës në Senatin amerikan, po drejtonte një seancë në lidhje me hetimin mbi ndërhyrjen e supozuar ruse në zgjedhjet presidenciale amerikane, kur edhe tha se shënjestra e radhës mund të ishte Franca. "Unë mendoj se është e dukshme në gjykimin e kujtdo se rusët janë të përfshirë në mënyrë aktive në zgjedhjet në Francë. Pjesë e përgjegjësisë sonë është të edukojmë edhe pjesën tjetër të botës", tha ai. Ky paralajmërim, u rikthye në vëmendje këtë javë pas zbulimit se pjesëtarë të stafit të Emanuel Macron, favorit kryesor në balotazhin e pritshëm, janë sulmuar nga hakera të dyshuar rusë. Lajmi nuk është i papritur në kampin macron apo për ekspertët që thonë se Rusia po punon në prapaska për të



Marine Le Pen

përmbytur rezultatin në favor të kundërshtares së tij Marine le Pen. Por, ndërsa Rusia ka mohuar akuzat për hakërim, frika për ndërhyrje të mundshme të kremlinit tani është e dukshme ndërsa zgjedhësit përgatiten të shkojnë në votime të dielën e ardhshme. Rusia thotë se nuk ka një kandidat të preferuar në zgjedhjet franceze, por ka

arsye të mira për të mbështetur Le Penin. Qëndrimi i saj anti Evropë dhe anti NATO, është në një linjë me interesat ruse dhe ajo ka kërkuar lidhje më të ngushta me presidentin Vladimir Putin. Le Pen, po ashtu ka shprehur edhe dëshirën për të tërhequr sanksionet e BE-së mbi Rusinë pas aneksimit të Krimesë të cilat ajo i ka quajtur

të padrejta. Është ky një qëndrim në kontrast të thellë me atë të Macron, pro evropian dhe pro integritit që ka thënë se është pro sanksioneve mbi Rusinë e madje do të donte edhe t'i shtonte ato. Ndërsa Macron ka kandiduar si i pavarur, Le Pen ka bërë fushatë deri më tani si kryetarja e Frontit Nacional të së djathtës ekstreme. Ajo përballet edhe me kritikën se fushata e saj është financuar pjesërisht nga një bankë ruse. Por, ajo thotë se nuk kishte pasur zgjedhje tjetër pasi bankat franceze e kishin refuzuar. Madje shumë dyshime pati edhe kur Lë Pen udhëtoi drejt Moskës për një takim me Putinin muajin e shkuar. Putin nënvizoi rëndësinë e lidhjeve të ngushta franko-ruse edhe pse Kremli insiston se nuk ka të preferuar në zgjedhje në një kohë kur pozicioni i Lë Penit mbi Rusinë është i qartë.

## Veprat e zhdukura

# Pse Kuteli, mjeshtri i rrëfimit mbetet ende i pazbuluar



► Mitrush Kuteli

NGA BEHAR GJOKA

Ndërsa po rilexoja "Testamentin", tekstin e fundit të shkruar prej Kutelit, kuptova edhe njëherë pse mjeshtri i rrëfimit dhe tregimtarisë i letrave shqipe mbetet i [pa] zbuluem përjetësisht. I pazbuluem sepse humbja, nëse do ta kundronim jetën dhe veprën e tij, është gati e përputhur me triumfin dhe prurjen letrare. Përveç ndarjes nga jeta, një humbje e parakohshme, janë humbjet e tjera, sidomos ato letrare që ta tërheqin vëmendjen për ta kundruar vemendshëm si dukuri. Dhe nuk janë dosido, po të shumta dhe të

mëdha, e një pjesë e tyre pothuajse të paraparueshme. Në gjallje Kuteli nuk mori asnjë lëvdatë si shkrimtar, jo se kishte nevojë, por se ai me veprën e larmishme letrare, veçmas me lëvrimin e prozës pati krijuar shkollën e rrëfimit dhe të tregimtarisë shqipe. Në fillimet e jetës letrare, fal përku-jdesjes së tij, realizohet botimi i poezive të Poradecit, Emineskut dhe F. Nolit.

Madje librat e këtyre poetëve janë shoqëruar edhe me hyrje të gjata, në nivel të shqyrtimit kritik, pra si metatekste të mirëfillta të zbrërthimit të veprës së tyre poetike, një modelim i shkrimit të kritikës

letrare. As kjo punë fisnike, madje që atij i shkakton shpenzime të shumta dhe kohë të humbur, nuk e pati mirënjohjen dhe kujdesin e kulturës dhe të institucioneve të saj. Në vitin 1947, që përkon me shkrimin e novelës "E madhe është gjëma e mëkatit", për arsye politike Mitrush Kuteli përfundon në burg. Nëpër njëzet vite, anktheshumë dhe tronditëse, vazhdon kalvari i tmerrit për jetën dhe bukën e gojës.

vijon në faqet 14-15

■ **Trashëgimia e humbur/** Si u zhduken veprat e Kutelit, dy novela, një roman dhe një dramë

■ **Përvjetori/** Më 4 maj shënohet 50 vjetori i vdekjes së shkrimtarit Mitrush Kutelit



## Si u krijua "Dumvirat" - i Ball-Legalitetit pa dijeninë e Zogut

Në janar të vitit 1945, dy politikanë shqiptarë, ndonëse të internuar nga aleatët në një kamp transit në Bari, i mirënjohuri Mid'hat Frashëri, që ishte kreu i Ballit Kombëtar dhe një klerik nga Shkodra, Sali Muftija, ky i dyti, në emër të organizatës "Legaliteti", i kanë kërkuar Sekretarit amerikan të Shtetit në detyrë, të mos ndërmerret asnjë nismë për njohjen e qeverisë komuniste, të krijuar që para çlirimit të vendit. Ky dokument bëhet i njohur në vitet 2000. Gjithsesi, ngjall kërshëri historike...

NGA MARK BRUNGA

faqe 20-21



## Thanas Medi, "Kohë e djegur-koha e pakohë"

Ç'do heqë i shkreti djalë, ç'do heqë!-thotë gjyshja duke lexuar fjalët e nuseve të qiellit që kishin zbritur për të parathënë ç'do të ndodhte në jetën e djalit të porsalindur.

Ashtu si në tragjeditë antike, kur njerëzit shkonin te orakujt për të shpjeguar ëndrrat e tyre, ashtu si tri magjistricat i thonë Makbethit e Bankos fatin që i prët, ashtu si në veprën e Markezit gjithçka ndodh siç është parathënë, ashtu edhe tri nuset e qiellit zbresin ditën e tretë duke vulosur fatin e djalit duke lënë një shenjë...

NGA NATASHA XHELILI

faqe 18-19

## 50-VJETORI | I VDEKJES

NGA **BEHAR GJOKA**

vijon nga faqja 13

Këtu, pikërisht në këtë çast frikësor, në mënyrë të paimagjinueshme ndërpritet edhe ëndrra e shkrimtarit.

Tashmë, me lejen e redaktorëve të realizmit socialist, ai do të merret me përkthimin, me përkthimin e normuar në mënyrë të zyrtarshme, me përkthimin detyrim ku u përfshin me dhjetëra mjeshtrë të kulturës dhe letërsisë, të cilët vinin nga periudha e mëparshme. Përkthimet mjeshtrë të Gogolit, Eminesku, Ostrovskit, Turgenjevit etj, jo vetëm i dhanë bukën e gojës për vete dhe fëmijë, por mbajtën të ndezur edhe "kandilin" letrar, atë ëndrrën e madhe të autorit, për të cilën ishte gati që të sakrifikonte gjithçka.

\* \* \*

Në këtë periudhë terri, torturash, burgimesh, ndalimesh, internimesh dhe letnimit, Kuteli, megjithatë arriti të botonte librat: "Xinxifillua", me përallat dhe "Tregime të moçme shqiptare", ritregime të epikës legjendare dhe historike të folklorit shqiptar. "Kandilja" shkrimor kuteliane, edhe në kushtet e terrorit diktatorial, rrezaton dritë, art, përthekime letrare edhe në këto hapësira të ngushtuara të shprehësisë letrare, pra një mosthyrje e habitshme karakteriale.

Prapë asnjë rresht për ta përmendur punën e madhe krijuese në dobi të kulturës shqipe, një heshtje vrasëse më e ndyrë se sa sulmi dhe përndjekja. Përmasat e prozatorit, si tregimtar, novelist, ligjërues rrëfimesh dhe rrëfimesh, ishte formatuar plotësisht para lirit të vendit nga fashistët, ku bie në sy numri i madh i botimit të librave me prozat e larmishme. Fitimtarët, në pushtet dhe kulturë, ishin vënë në gjurmë të peshkimit të artistëve dhe shkrimtarëve, pa talent dhe biografi shkrimtare, në kërkim të shkrimtarit shërbëstar.

Gjithnjë sipas modelit (gjedhit) letrar soçrealist, fakti që Kuteli ishte i formuar si shkrimtar dhe intelektual, madje me personalitet të spikatur, për këto arsye dhe të tjera, ai i trajtua si dru i shtrembër, që do të duhej mënjantuan nga udha e letrarëve fitimtarë. Shmangia erdhi rrufe, erdhi e tmerrshme, edhe pse intelektual i Dhimitër Pasko, i doktoruar në Rumani për financat, kishte mbrojtur monedhën shqiptare në dy raste; nga pushtuesit nazist, si dhe nga synimet e komunistëve jugosllavë. Mbase, këto ngjarje, që nxorën në pah aftësitë e avokatit të ekonomisë shqiptare, u bënë shkaku kryesor, që ta përzinin njëherë e përgjithmonë nga institucionet shtetërore. Përzënia e parë përgaditi dhe shtroi udhën për përzënie të madhe prej panteonit të letrave shqipe, nga mundësia për ta ushtruar ndikimin e vetë legalisht, çka pati ngjarë pa pengime gjer në vitet 1944. Në vitet e territ të ndritur ngjau ndëshkimi i paimagjinueshëm



▶ Mitrush Kuteli

# Veprat e zhdukura

## Pse Kuteli, mjeshtri i rrëfimit mbetet ende i pazbuluar

**MË 4 MAJ SHËNOHET 50 VJETORI I VDEKJES SE KUTELIT/ Si u zhduken veprat: novela "Dashuria e barbarit Artan për të bukurën Galatea" dhe gjysma e novelës tjetër, "Sbulesa e dytë e Pjetër Kulirës nga Liqerasi", një roman kushtuar të burgosurve të kampit të Prishtinës, drama "Ura", apo "Rrëfimet me të gjallë e me të vdekur"... Një hulumtim për humbje të tjera përtej kësaj panorama. Në jetën e rrëfimit të madh pati shumë të tilla**

i mjeshtrit të fjalës shqipe.

Sa që gjallë, me frymë e forcë të jashtëzakonshme shpirtërore, nuk preku dhe ndjeu as vlerësimin më të vogël si shkrimtar, prozator dhe poet,

kritik dhe përkthyes, si botues dhe intelektual. Mbase prania e këtyre shenjave dhe shenjzimeve identifikuese, u bënë shkasi kryesor për ta goditur me të gjitha format: goditje

fizike duke e burgosur, goditje shpirtërore duke ia vrarë ëndrrat për një Shqipëri demokratike, goditje letrare duke ia heshtur veprën letrare, botuar para lirit të vendit nga

pushtuesit, e sidomos ndërprerjen e ëndrrës letrare duke e detyruar, në mënyrë pseudodemokratike apo diktatoriale, që të përkthente me normë dhe jashtë dëshirës dhe shijes letrare të shkrimtarit.

\*\*\*

Ndëshkimi në gjallje, merr fund me ndarjen e parakohshme nga jeta, më 4 maj 1967, pra pa i mbushur as gjashtëdhjetë vitet. Pas këtij momenti zë fill periudha e dyzuar, e pranimit-mospranimit të veprës letrare të Kutelit. E pranimit, sepse qysh në vitet 1972 nisi botimi i krijimtarisë së gjerë letrare, siç është vërtuar nga verifikimet e mëvonshme duke krahasuar dorëshkrimet me tekstet e botuara, vërtet duke ia ndryshuar disa trajta ligjërimore gjuhësore, gjë që do të thotë se kemi të prekur autentiken, autoriale, pra e një pranimi gjysmak të veprës së shkruar. Ndërsa në fillim të viteve '80 duket edhe ndonjë konsideratë, e përgjithshme dhe krejt e përciptë rreth veprës letrare kuteliane, e tipit "mjeshtri i rrëfimit", një frazë ekuivoke, sepse në krijimtarinë e Kutelit, rrëfimi është edhe lloji letrar, njëri nga më të dashurit e shkrimtarit, por është edhe mjete i poetikës së prozës. Ngatërimi emërtues nuk ka gjasa të jetë i rastësishëm, përkundrazi është një qëndrim prej xhirafe, fshehje e kokës në rërë me shpresë se ka shpëtuar edhe trupi, nga ana akademikëve.

Ku formulim, por edhe të tjera të matura me metrin e akademistëve të soçrealizmit, lë në hije tipologjinë e zhanreve të lëvuara prej autorit, si dhe thelbin e prurjes së shkrimtarit, ligjërimin e prozës moderne. Kuteli dhe Koliqi, me prozën e larmishme të lëvuara para mbarimit të luftës, kanë meritën e shkëputjes së prozëshkrimit shqip nga moralizimi, rapsodizmi bisedimor dhe shtjellimi monoton, dhe e futjen në vijën [hullinë] e lëvimit bashkëkohor si frymë, si teknikë dhe shprehësi letrare.

Në fillim të viteve '90, nën përgjegjësinë e N. Jorgaqit, botohet e plotë, së paku sipas shënimeve të bëra, vepra letrare e M. Kutelit, me pesë vëllime, ku është përfshirë poezia, proza, ktitika letrare etj. Megjithatë, edhe në këtë sipërmarrje, simbas studimeve të mëvonshme letrare, lihen jashtë botimit disa tekste origjinale të shkrimtarit, dhe tanimë thellohen ndryshimet gjuhësore, të cilat e kanë zbehur ndjeshëm praninë shkrimore të autorit. Pas viteve '90, që përkon me shembjen e diktaturës komuniste dhe fillesat e demokracisë shqiptare, figura e Kutelit i kthehet vlerave letrare të shqipes, zë e zbulohet si vlerë letrare e mëvetësishme, madje në jo pak raste hienat e studimeve të dikurshme tentojnë të fshihen prapa artit të Kutelit për të mbetur qendër e verifikimit letrar, kur me shqyrtimet e kryera vërtetojnë se u ka mbetur ora në studimet sociologjike dhe ideologjike.

Mendimi hedhur nga M. Camaj, se Kuteli është ende i pazbuluar, vijon të nxisë kërsërinë e leximit, shfletimit dhe shqyrtimit të pambarrim të krijimtarisë së mjeshtrit të prozës shqipe.

\* \* \*

Kjo ide, pra se Kuteli vijon të jetë i pazbuluar, nxit studimet për ta interpretuar pjesën që e trashëgojmë, e patjetër për të thelluar kërkimet për humbjet e mëdha, për humbjet të cilat gjithsesi nuk zbehin literaretin në tekstet e lexuara, shqyrtuar nga studimet letrare. Merita të posaçërisht, sa i përket mënyrës shkrimore kuteliane, në lëmin e prozës posaçërisht, bart edhe sintagma "mik tre ditësh

rymash letrare, si e pati formuluar M. Camaj, këtë përvore shkrimore. Formatimi i mjeshtrit për mjeshtrin si "mik tre ditësh" sjellë me vete shumë shenja dhe mbishtresime letrare, të cilat fokusojnë dimensionet reale të autorit:

Së pari: Se Kuteli është i paqëndrueshëm në raportimin e vetë me letraren. Paqëndrueshmëria në art nuk është e barabartë me mosqëndrueshmërinë në jetë, e rrafshit etik, pra si karakter i paqëndrueshëm, në idealitet si gjurmë e ndryshimit të menjëhershëm. Paqëndrueshmëria në art dhe letërsi është diçka tjetër, mbase është vetë thelbi i qëmtimit dhe materializimit të letrares.

Së dyti: Se artin e fjalës, Kuteli e mendon dhe e realizon në dinamikën e lëvizjes, në dinamikën e kërkimit të vlerave letrare, të vlerave si thënie dhe shprehësi letrare. Paqëndrueshmëria ndaj rrymave letrare është tregues i kërkimit të letrares në të gjitha vatrat ekzistenciale.

Së treti: Se fakti i lëvrimit të trija gjinive letrare, poezisë, prozës dhe dramatikës, faktologjia e shkrimit të gjithë llojeve të prozës, tipike si: tregimi, novela, romani, të prozës me origjinë orale, si rëfimi dhe rëfenja, të prozës së rishkruar nga poezia dhe drama, tashmë në formën e ritregimit, e pasqyron natyrën e mosqëndrueshmërisë si vlerë letrare, si vlerë e dinamikës dhe kërkimit të pafundëm.

Leximi me teze, edhe në këtë ndërkohje, i veprës letrare të Kutelit, gati ka pamundësuar komunikimin real me veprën e shkrimtarit, madje edhe keqkuptimin e shpërdorimit të vlerave letrare të krijuara prej tij. Vizioni i leximit sociologjik, madje duke e menduar si të vetmin, çka shprehet me krenari edhe nëpër tryeza shkencore, e vështirëson leximin dhe shqyrtimin e teksteve të autorit. Leximi i realizimit të Kutelit si realizëm grotesk, nuk shjeggon dot magjinë letrare të Kutelit, por e fut në qorsokak trajtimin e prozës së autorit. Teoritë letrare, klasike dhe moderne, në të gjitha trajtat dhe lakimet e veta, deri më tani ofrojnë trajtimin e konceptit realizëm, me tre ngjyresa: realizëm kritik, realizëm socialist dhe realizëm magjik. Qenia akademik në këto trajtime dhe përcaktime shpikje, nuk e lehtëson situatën, përkundrazi ajo tregon se çfarë lloji akademikësh na vijnë nga koha e Babaqemos.

\*\*\*

Po ashtu leximi eseistik, një mënyrë interesante, por e pacitueshme si trajtim shkencor, nuk e zbërthen vlerën e teksteve të Kutelit. Pra, bashkë me zbulimin në këtë periudhë është thelluar edhe keqleximi, keqinterpretimi i veprës letrare të Mitrush Kutelit, herë-herë duke e përfshirë në situata të çuditshme interpretimi. Titujt e shqyrtuesve, nuk mbrojnë dot nderin e nëpërkëmbur prej vetë atyre. Leximi ideologjik, një term i K. M. Shalës, për të gjithë autorët, e veçmas për Kutelin duhet të marrë fund. Kjo është njëra nga humbjet e jashtëzakonshme, që e lë në hije mjeshtrin e prozës shqipe. Këto që përmendëm, pra mospërfilljen e veprës letrare, përthimorë, kritike dhe botuese, përsa kishte frymë, botimi i cinguar letrar dhe gjuhësor i krijimtarisë letrare autoriale, si dhe leximi i pamundshëm sociologjik dhe ideologjik prej studiuesve dhe estetëve të estetikës së brendisë, që kanë shpërfillur formën, janë një pjesë e vogël e humbjes së madhe, humbjes së disa teksteve letrare. Këto humbje të mëdha dhe të pariparueshme, na i bënë me dije A. Pasko, e bija e shkrimtarit. Ndër të tjera shprehet: "humbi tërë novella



► Mitrush Kuteli

kryesore, "Dashuria e barbarit Artyan për të bukurën Galatea" dhe gjysma e novelës tjetër, "Sbulesa e dytë e Pjetër Kulirës nga Ligerasi. Humbi edhe një roman që u kushtohet të burgosurve të kampit të Prishtinës si dhe drama "Ura", me motive të legjendës së murimit... S'dihet ç'u bënë edhe librat "Rrëfimet me të gjallë e me të vdekur" dhe "Shënime ekonomike." Humbja është e madhe dhe dyfishtë:

- Humbja në lëmin ekonomik, të fushës së financave, e cila do të sgaronte përmasën e intelektualit dhe të ekspertit në fushën financiare. Nga njoftimet e medias është marrë vesh se këto shënime do të botohen deri në muajn shtator dhe do të paraqiten para lexuesit në kuadrin e

100- vjetorit të lindjes së shkrimtarit. Është një shenjë e mirë e kthimit të pranisë së vlerave të krijuara nga Kuteli.

- Humbjet në lëmin e letrave, pra të teksteve letrare të autorit, e cila është më e thellë dhe mbase e pariparueshme. Është më e thellë sepse në mungesë të tekstit të dramës, portreti i shkrimtarit do të mbetet përjetësisht i paplotë. Po ashtu, në mungesë të romanit të dytë të Kutelit, kushtuar të burgosurve të Prishtinës, ngelet në zgrip teza e shkrimit të romanit prej autorit, natyrisht mbetet pezull prej atyre lexuesve, e sidomos prej atyre studiuesve, graduar si akademik nën kudhrën e socrealizmit, pra kryekëput prej atyre që nuk duan ta shqyrtojnë realisht tekstin mbi Enkelinë si roman. Megjithatë, prania e tekstit të romanit mbi të burgosurit e Prishtinës do ta dyfishonte tezën e shkrimit të llojit të gjatë, romanit nga autori.

\*\*\*

Edhe në lëvrimitin e novelës dhe të rëfimeve humbja është shumë e madhe, aq sa konkluzionet për krijimtarinë autoriale nuk e përmbushin dot boshëtirën e krijuar për shkak të humbjeve të konsiderueshme. Pajlotënia shkrimore e Kutelit, në dramatikë, prozën e të gjitha llojeve, është shenjë e pamundësisë për ta kuptuar dhe shpjeguar universin letrar të shkrimtarit në caqet e plota të përfaqësimit. Megjithatë, kjo pajlotëni e vlerave letrare të sendërtuar prej tij, nuk ka se si të frenojë dhe të pengojë shqyrtimin e teksteve letrare kuteliane, të atyre teksteve që trashëgojmë, veçse tanimë interpretimi të realizohet në nivel të formës dhe formësimit letrar, të strukturës dhe shprehësisë letrare, të rrafshëve të rëfimitarisë, aq të larmishme dhe si shenjzë vlerash letrare.

Humbjet e të gjitha llojeve, por veçanërisht ato të teksteve letrare, erdhën prej rethanave jashtëletrare,

nga burgimi, letnimi dhe përndjekja e pandërprerë. Për arsye letrare, si të thuash të prekjes dhe shijimit të letrares magjike, të asaj esencës shkrimore, sidomos në lëvrimitin e prozës, papërrjashtim në shkrimin letrar të gjithë llojeve të saj, ka kuptim interpretimi i faktologjisë letrare të realizuar prej shkrimtarit. Faktologjisë letrare, që ka shpëtuar nga përndjekja e diktaturës, e cila tashmë nuk ka pengesa botimi. Leximi, shfëltimi, shqyrtimi dhe rivlerësimi i teksteve të shkruara si variante dhe versione, i teksteve metatekste ose i kritikës letrare, aq të parapëlqyer dhe të lëvruar me sukses nga autori, i teksteve në poezi, në poezitë drithëruese kushtuar



► Mitrush Kuteli

vendlindjes, e veçmas në vargjet lapidar të "Poemit Kosovar", një krijim i shkëlqyer i atdheut virtual, i atdheut real, por të ndaluar prej rethanave dhe paderjtësie, i gjysmës së Shqipërisë, të ndarë në fillimshkullin e kaluar.

Pjesë e vëmendjes së studimeve

bashkëkohore, e rivlerësimit dhe vendosjes në vendin ku i takon, në krye të vlerave letrare të shkrimit të prozës, duhet vënë edhe trashëgimia në këtë gjini, tregimet, rëfimet, rëfenjat, novelat, dhe mbi të gjitha të jepet një përgjigje e plotë dhe e argumentuar e faktit të lëvrimit të romanit, madje e shkrimit me kualitet, nëse e kundrojmë vëmendshëm prozën e gjatë mbi Enkelinë.

Proza në duart e Kutelit, vetiu shpërndërrohet në mrekulli letrare, në magji që të befason dhe të mbush shpirtin plotë ndjesi të holla. Dhimitër Pasko, alias Mitrush Kuteli, emri i tij letrar, nga këto humbje që u vunë re, të cilat nuk janë të vetmet, mund të vështrohet si shkrimtar i humbjeve të mëdha, madje i humbjeve të pazvëndueshme. Prania e tij, me tekstet e botuara në poezi, prozë, kritikë letrare dhe përthimim, paprانيا prej humbjeve të ndjeshme në analizat ekonomike, dhe tekstet letrare, janë në ekuilibër të habitshëm, në ekuilibër që nuk e humbet autorin, përkundrazi na e zbulon në një dritë të dyfishtë, që flet me praninë dhe papraninë.

\*\*\*

Megjithëkëtë, falë mjeshtërisë rrëfimorë dhe tregimtarisë së shkrimtarit, prania e Kutelit është më e fuqishme dhe më funksionale se sa paprانيا. Prania e Kutelit, si përvore shkrimi letrar dhe krejt origjinale në tekstet në prozë dhe patjetër edhe në shkrimet e tjera letrare, në poezi dhe kritikë letrare. Kjo prani është e prekshme me ndikimin e vetë mbi shenjat e literaritit të letërsisë moderne shqipe. Pra, humbjet e shumta në tekstet e prozës së shkruar prej Kutelit, por edhe të pagjetura, pra të panjohura dhe të pavlerësuar, që ngërthen në vetvete një sasi të përfillshme vlerash letrare, nuk zbehin përfundimisht tipologjinë shkrimore kuteliane, e cila shpëmdrit plotëninë e magjisë letrare në sendërtimin e rëfimit dhe rëfenjës, proza këto që e kanë

origininë tek arti gojor, me realizimin cilësor të tregimit dhe novelës, me tonalitetin dhe ngjyresat mbresëlënëse të pagjashme në letrat shqipe, me shkrimin e romanit me nivel të ngritur literaritit. Pohimi i bërë nga shkrimtari në fund të "Testamentit": "Terreni i letërsisë është një tokë tek gëlojnë gjarpërinjtë. Të vrasin shokët, se u bënë hijë. Dhe kur nuk bënë hije do të thonë se nuk je i zoti për letërsi.", sikur është shkruar enkas për këndej kohën, kur mbarshohet estetika e refuzimit estetik, estetika e përbaltjes dhe jo e komunikimit ndërmjet të ndryshmeve të barabartë, jo në dije dhe vullnet, po në të drejtën e shprehjes.

Kuteli, emri dhe vepra e tij letrare, pavarësisht humbjeve të konsiderueshme, në historinë e letrave shqipe, ka një vend të veçantë, çka lidhet ngushtësisht me prurjen letrare, e veçanërisht me tekstet e shkruara prej tij, të cilat aspirojnë dhe sendërtojnë letraren në kuptimin e parë të kësaj fjale. Letraren që e shpërfill kon-tekstet dhe rethanat jashtëletrare. Letraren si magji e shprehësisë dhe shumfishësisë emocionale, letraren që i braktis patericat ideologjike dhe ndërkomunikon vetëm si art, si esencë letrare e pastër, pra si paraqitje e pastër e njëmendësisë.

50-VJETORI | I VDEKJES

# NË PRIZREN, MIDIS TË VDEKURVE DHE TË GJALLËVE

NGA MITRUSH KUTELI

**P**o të jetë se vini në Prizren – për ndonjë punë më të kthjellët se kontrabanda – mbasi të keni shijuar bukuritë pa shoq të këtij vendi të qetë edhe gazet e jetës të të gjallëve, mos harroni të vizitoni edhe banesat e të vdekurve. Sa burra të lartë e sa vasha e zonja të hijshme që adhuron qysh shëtisin aty te Shatrivani a në këmbë të Xhamisë të Sinan Pashës ose mbi Urën e gurtë, janë një pikë ujë në një det, në krahasim me numrin e atyre që çlodhen nën dhe. Nuk di nëse këta, atje ku janë e ku s'janë, e ndiejnë çapin tonë e në kanë ndonjë gaz, në mënyrën e tyre, po di se shpirti ynë del, nga këto parakalime për në banesën e fundit, më i platitur, më i njerëzishëm e mbase më i larguar nga kotësirat e tokës.

Ah, është fort e rëndë të vizitosh gjithë varret e një qyteti kaq të madh e kaq të vjetër, se janë të shumtë e të përhapur. Dhe shumë gjurma janë zhdukur. Po ne bëjmë sa mundim.


Ja, të kalojmë së bashku Urën e gurtë me harqe venetike, aty afër Xhamisë të Sinan Pashës, e të shkojmë ngadalë, nëpër disa rrugë shumë të ngushta e të dredhuara (mua këto më pëlqejnë më shumë se rrugët monotonisht të drejta, të hapura me litar, të qyteteve të reja) gjer te Xhamia e Bajrakliut. Përpara kësaj Xhamie me minare çuditërisht të hollë, si fije kallmër, është një oborr dhe në oborr disa varre të vjetra zonjash e zotërinjsh, nga të fuqishmit e një kohe. Tani, kur asnjë dorë nuk zgjatet t'i përkujdesë, as varret as qoshkun aty pranë, pllakat e mermerta kanë rënë poshtë, ku i shkel këmba dhe i bluan koha. Do dëshëroja fort të lexoj mbishkrimet, me një ato fantastike kaligrafi arabe, që asnjë nga alfabetet e ngurta evropiane nuk mund t'iu afrohet nga bukuria. Po nuk di, dhe jam i dëshpëruar se ndofta nuk do di kurrë. Megjithatë më pëlqen t'i vështroj e t'i prek me gishtrin. Sepse më duket se kur i prek me gishtrin këto veprat e artit skulptural, i afroshesh shpirtit të artistit që i punoi.

Ja, të gjithë të vdekurit të këtushëm që flenë nën shenjën e komplikuar të svastikes ariane në trajtë dielli, që i patën sjellë dikur të gjallët, me bujë e me lot. Pastaj u ardh radha edhe atyre të ikin nga kjo botë – si na ka për të ardhur edhe neve, nesër – dhe mbetën të shkretë.

Është mirë të rrih disa orë këtu në oborrin e Bajrakliut (dhe unë pata ndenjur, shumë herë) se uji i çezmave dhe shushëllimi i vijës të preh, po ne sot kemi për të bredhur më. Zbresim, si pa qëllim, nëpër arabeskun e rrugëve të qytetit të cilin Zoti



▶ Mitrush Kuteli



e dhuroi me ujra shumë.

Ja këtu, një portë e madhe me një yll e gjysmë hënë përsipër. Porta është e hapur. S'ka njeri për të pyetur. Zgjatim kryet në një dritore. Brenda varre – janë gjashtë – me kësula e çallma të rënda përsipër.

## DHE PRANË-PRANË BANESA/ KËTU JETA – ATY VDEKJA.

Sa qetësi në oborr! Një shatrivan, me ujë të kulluar, nën një pjergull. Një trëndafil i çelur, një zog që këndon. Jemi në muajin maj... Shkon një njeri. Pyes e më përgjigjet:

Varret e para janë varre jabanxhinjsh, miq të Teqesë që i arriti vdekja aty. Varret e tjera janë të baballarëve të Teqesë, duke filluar me Sheh Osmanin, dhe pas tij, Sheh Ahmeti, Sheh Sinani e katër të tjerët. Edhe këtu qetësia e Zotit të thotë: rri. Po ne jemi udhëtarë e nisemi.

Që aty te lumi duket, mbi një kodër, Kisha e Shën Spasit ose Kisha e Gogëve (e vllëhëve) si i thotë populli. Kjo ka historinë e saj. Sërbët e kanë djegur disa herë në kohën e Turkut, se vllëhët nuk pranonin gjuhën serbe në kishë. Ka atje disa varre të vjetër, me kryeshkrime greqishte që mund të na shërbejnë si dokumente historike për të vërtetuar se pjesa më e madhe e popullsisë serbe e Prizrenit është, në realitet, një popullsi shqiptare-rumune e sërbiuar përmjet kishës, dhe e cila, dikur, ka dashur të rojë jetën e vet kombëtare.

Varret e reja, të sotmet, të Prizrenit janë përtej, në hyrjen e qytetit. Që t'arrijmë atje mbajmë krahun e djathtë të lumit. Mos qëndroni fort këtë radhë në urat për të vështruar ujët e shkumbëzuar që rrjedh poshtë e as mullinjtë e shumtë. Pa fjalë se këta janë më të mirë, se ai i Xha Brahos të Shkumbanores. Kanë nga pesë e gjashtë gurë. Po ne do vijmë



► Mitrush Kuteli në liqenin e Ohrit

tjetër herë t'i shkelim. Arrijmë në ura e fundit – urë e drunjte. Duhet ta kalojmë.

Ja aty, më të djathtë, një fushë e madhe me varre: Varret e muslimanëve. Rrasa të rrepta prej guri të hirtë. Shumica pa kryeshkrime. Disa që kanë, janë arabisht. Bari është i gjelbër, i freskët, po ne mundim të kalojmë përmes se dielli e piu vesën e mëngjesit. Aty nën një hije fle një njeri: i qetë, me duar nën kryë, pranë një guri. Si nesër do flerë gjith' aty, po nën dhe, përgjithmonë.

Varret e ortodoksëve, nënë sallkëmet e lulëzuar. Janë varre te kujdesur mirë këta të borgjezisë serbe, zotëronjëse në vitet e fundit. Gurë me shkronja të arta, lule, fotografi.

Reshpërojnë gra shumë, veshur nën të zeza. Pata besuar, në fillim, se do ish ndonjë varrim, po jo. Sot qënka e Shtuna e të vdekurve, 22 maj 1943. Vaje e lotë shumë. Kështu është ortodoksia: mistike, sentimentale, lakrimogjene.

Aty, pranë një varri të freskët është shembur një grua e re dhe qan e lodhur, e dërmuar. Përtej, disa të tjera, me zhurmë. Disa gra rrahin të ngrehin që poshtë, me këshillime, një plakë që vajton edhe përsërit litaninë "dushe moje, dushe, dushe, dushe", "shpirti im, shpirt, shpirt, shpirt". Një tjetër i drejtohet të birit, që tretet brenda, me një fjalë serbisht – një shqip: "sine – bir-o! sine – bir-o!" E qan e dëshpëruar. Është pa fjalë, ndonjë shqiptare a ndonjë rumune nga Shqipëria (shumë nga gogët e Prizrenit janë të ardhur nga rrethi i Korçës edhe i Manastirit) tani e serbizuar, po e cila birit të vdekur i thotë në gjuhën e vjetër gjith' "bir-o".

Ka ngashërime shumë dita e sotme dhe mund të lotojmë duke kujtuar të vdekurit tanë, sado që sallkëmi është i lulëzuar dhe shpeshët këndojnë.

Po, shpeshët këndojnë e midis varreve... Shkon aty pranë një foshnjë nën të zeza që e heq për dore një nënë gjith' nën të zeza. Sa ngjyrë e tmershme kjo e zeza! Zonja loton dhe foshnja vështron shpeshin që këndon aty mbi degë, se ajo nuk di dhembjet e lotit të vërtetë.

T'i lemë varret e ortodoksëve me shkrime te rënda kirilike përsiper. Flenë këtu brenda kaq kombësi të serbizuara. Ne shkasim më tej dhe kalojmë kufirin e gjelbër që ndan varret ortodokse nga varret katolike. Po, vetëm një vije e gjelbër, kurse varret e Shkodrës ngjet të rrethohen me mure e me porta të hekurta, me katinare të rëndë.

Ah, këtu në varret e katolikëve të Prizrenit ka mbishkrime shqipe! Shqipe – në kohën e Turqisë dhe të Serbisë! Është ky një afirmacion shqiptar i shkruar vendimtarisht dhe vizojmë, me ngjyra të dukëshme, si një nga shprehjet e ndërjegjes kombëtare. Emra të njohur: Shirokanj, Mjedanj e të tjerë.

Ja një varr mjaft i moçëm, me një kryq të rëndë. Dhe mbi kryq një mbishkrim: "Këtu pushojnë Balta e Mana Tarabolluzi të mbytur prej Lumjanve më 2 Tetuer 1880". Kanë aty edhe fotografitë e tyre. Balta me kostumin si gjiritli, me pantallona të zeza të gjera; Mana në dimit e vendit.

Kam pyetur në qytet për tragjedin' e Baltës dhe të Manës: Balta ka qënë tregëtar i madh (shtëpia e tij e shembur është aty, pranë kishës katolike). Dhe trim. Kish patur një grindje me Destan-policin për një gjerdhan florinjsh të lënë amanet. Destani i solli lumjanët që ta vrasin. I rrethuan shtëpinë, natën. Balta e Mana, burrë e grua "kan pas qit pushkë" me trimëri të madhe sa u këndohet edhe sot kënga në Prizren:

Mana mush e Balta qit/ I Madhi Zot mos na korrit/ Moj Mane, moj krajlicë/ Na kallshe ç'at dite/ Se kan ardh cubat me të mbytë.

Kanë luftuar me trimëri, po lumjanët ishin të shumë dhe i kish sjellë Destan-polici vetë. Një lumjan ra në oborr, një brenda në lesh (se Balta bënte edhe tregti leshi) e një tjetër s'di se ku. Disa u patën plagosur. Po më në fund edhe Balta edhe Mana ranë të vvarë...

Tani shtëpia e tyre është e shkretë. Nuk u mbeti veçse kënga. Dhe kënga mjafton. A mos prej nesh do mbetet më shumë?

Po ja, atje, një tjetër varr, i rrethuar, me kangjella hekuri. Bari i varrit është i freskët, i madh, i kujdesur. Mbi kryq fotografia e një vashe të re. Një rusp përralle, me vija fisnike, aristokrate. Unjem e lexoj "këtu pushon Filja e Ukës Zef (Toçes). Leu më 16 Tetuer 1901, diç më 29 Shtatuer 1921". As njëzet vjet! Dhe kaq e bukur!

Më poshtë disa vargje mirë latuar mbi gur, me atë shqipen e vjetër të Veriut:

N'kohë ma t'mirën t'vajzniis  
Filja e Ukës sod ndroj jetë;  
Tuj kenë shembulli i pastris  
Vllaan e nanën shkoj me gjetë.  
Ku e pata ket rrezik  
Me i mbli baba fëmit n'dhe  
Me ditë t'soçme un jam fikë  
E nuk m'met asnji për bee.  
Ah! ti morde, moj katile,  
Shum rrenime bone n'fëmi,  
Ti na morre t'shkretën File  
E kështu m'lee me duer n'gji.

Strofa e fundit është më mallëngjenjëse nga të gjitha, po e ka mbuluar bari i freskët, aty rrezë kryqit. Flet vetë e vdekura: T'lutem

Babë mos m'u idhnue/ Malli i Vllaut fort m'ka mollisë

A, përsëri ky bari i mbulon shkronjat. Jo vetëm bari, po edhe një shkëndijë që më shkrep në sy. Të jetë ushtima e këtyre vajtimeve që vijnë që përtej, nga varret e ortodoksëve, ose fjala e dhembëshme e kësaj Files së Ukës? Apo bukuria e vërtetë e vargut?

Vijon: Te nanë zeza du me shkue/ Me dite t'soçme t'kam braktisë/

### U DHEMB, LEXUES, U DHEMB?

As unë, as ju nuk e dimë cila pat qënë Filja e Ukës nga Prizreni. Dhe asnjë lidhje s'kemi me ta. Po vasha pat qënë e re, e bukur fort dhe fjala e saj ngashërimitare...

Tani të lemë qimitiret e të kthehemi në qytet e të presëm ndajnatën. Dalin asohere, kur skuqen në zjarr malet e Shqipërisë së Vogël, vashat e Prizrenit për të shëtitur aty në Shatrivani, në Xhamia e Sinan Pashës e gjer te Ura e gurtë me harqe venetike. Nuk është, pa fjalë, midis tyre, Filja e Ukës që tani u bë hi e tokë po edhe këto të tjerat motrat e saja prizrenase janë edhe ato fort të këndëshme në të parë. Një grua që di të vishet bukur, me fisnikëri e të shkelë lehtë, është një dhuratë e Zotit. Një veshje e hijëshme që plotëson bukurinë e natyrës së guas është edhe ajo një dhuratë prej Zotit.

Dhe Prizreni i ka që të dyja: Zonja e Zojusha të bukura që dinë të vishen bukur, të ecin me nur dhe veshje të hijëshme. Veshja karakteristike është çitjania, e sjellë prej turkut dhe e përshtatur nga gjithë elementet e vëndit: myslimanë, ortodoksë, katolikë. Sikush nga këto kategori i ka sjellë ndryshmeritë e ndjenjës së vet, duke bërë nga një veshje tipike një veshje specifike. Si bukuria zotëron, pa fjalë, veshja katolike, dimija, si i thonë zonjat e atjeshme, e plotësuar me valle, për të lidhur flokët, me parant, e me t'lesht që hidhet kraheve. Të gjitha me ngjyrat e forta të parverës: i kuqi shumë i kuq, i gjelbri shumë i gjelbër. Dhe të gjitha këto ngjyra të përzjera midis tyre, me trajtë lulesh e arabeske i bëjnë si një kopsht me lule që ecën, një gjylystan shëtitës që të çudit e të robëron.

Ja lexues, harroni varret edhe vështroni aty në Shatrivani: Tri zonja a tri zojushe zbrasin ngadal për në Ura. Ajo e së djathtës edhe ajo e së majtës, në kostume të Evropës. Veshur mirë, korrekt edhe shkelin bukur. Janë dhe të hijëshme. Dhe kanë shumë fisnikëri në ecje dhe në pamje. Po nuk na tërheqin vështrimin përveçse në mënyrë të dytë e të tretë. Sepse midis tyre është një mbretëreshë e veshur me veshjen e vëndit, që çmëndi gjithë Shatrivanin. Dhe çuditem qysh duron e qëndron vendit, në trunxh mbi gur, ky Abdyl Be Frashëri i Lidhjes së Prizrenit...

Është një gjylystan që ecën madhështor, zotëronjëse, robëronjëse. E të vjen, në se ke një shpirt, ta bësh qilim me lule e t'ia shtrosh në këmbë. Mbrëmave kthehem vetë për në shtëpi. A, nuk jam vetë, se hija më vjen pas, më del përpara, më shket djathtas, majtas, mi muret e avullive. Nuk është as çudi as lumturi të kesh hijen tënde me vete, po kujtoni se i trishtuari hero i Adalbert Shamiso-së nuk e kish më edhe ish i mjeruar për vdekje. Përpara meje një grup zonjash e zotërinjsh katolikë ecin ngadal, si për në dasmë. Dhe me të vërtet venë në dasmë, duke kënduar: Qit-mi, Nan se due me-i vesh, dhe më tej: Du me dal mun' ke dera...

Dhe kënga është e bukur dhe zërat të ëmbël dhe dritat lozin kur e kur mbi dimit e t'leshtat e tyre. Dhe hapen dritore, dhe hapen porta për të shikuar, për të dëgjuar.

Po mua më zotëron tani një valë dhembjeje. Dhe jo për jetën time që m'u bë fije-fije nër mërgime, as për të vdekurit e panjohur që pata folur më lart. Po për këtë Shqipërinë time që këndon këtu, e qan përtej...

RECENSA | ROMANI

# Thanas Medi

## Kohë e djegur- koha e pakohë

**Mbi romanin e fundit të autorit Thanas Medi, fitues i Çmimit Kombëtar të Letërsisë(2013). E mbushur me ngjyra dhe bestytini fshatare, vepra gjallon në dy vende e kohëra që përfaqësojnë dy kahe të ndryshme: periudhën diktatoriale dhe atë postdiktatoriale...**

NGA NATASHA XHELILI

### KURTHI I FATIT TË PARATHËNË

-Ç'do heqë i shkreti djalë, ç'do heqë!- thotë gjyshja duke lexuar fjalët e nuseve të qiellit që kishin zbritur për të parathënë ç'do të ndodhte në jetën e djalit të por-salindur.

Ashtu si në tragjeditë antike, kur njerëzit shkonin te orakujt për të shpjeguar ëndrrat e tyre, ashtu si tri magjistricat i thonë Makbethit e Bankos fatin që i prët, ashtu si në veprën e Markezit gjithçka ndodh siç është parathënë, ashtu edhe tri nusët e qiellit zbresin ditën e tretë duke vulosur fatin e djalit duke lënë një shenjë sa një thua të vvarë mbi hundën e tij.

Është kjo hyrja e romanit të fundit "Kohë e djegur" e autorit Thanas Medi, fitues i Çmimit Kombëtar të Letërsisë(2013). I shfaqur papritur në letërsinë shqipe pas disa botimeve sporadike në shtypin e kohës në vitet '80, ai vjen pas një periudhe reflektimi rreth 30-vjeçare, duke zbratur materialin e grumbulluar brenda tij.

Kohë e djegur është një kohë që nuk ka mundur të jetohej kur duhej, është si një kohë e mbetur pezull, si një jetë paralele që s'ka vend ku të vendoset, që është e pamundur të realizohet, por është një ëndërr nga e cila nuk duam të heqim dorë. "Sidoqoftë, ata të dy kishin kohën e tyre, unë isha si pa kohë. Si me kohë të djegur. Siç kisha qenë thujse gjithmonë në jetën time. Kohë të ngecur në ca çaste kulmore vërtet, por që ktheheshin shumë shpejt në kujtime."

E mbushur me ngjyra dhe bestytini fshatare, vepra gjallon në dy vende e kohëra që përfaqësojnë dy kahe të ndryshme: periudhën diktatoriale që sundohej nga përbashkësia dhe miti i individit dhe ajo postdiktatoriale që përveç rrëmujës, zbrazjes së fshatrave, derdhjes masive të shqiptarëve përtej kufirit, solli edhe shumë "liri" që u keqtrajtua nga shqiptarët.

Problemi i fatit të njeriut të ndëshkuar nga diktatura, trajto-

het nga një këndvështrim tjetër. Heroi e humbet rrugën në çastin e fillimit të persekutimit dhe çorientohet duke mos e gjetur më atë. Gjërat e mbetura në mes e djegin bashkë me dinjitetin e humbur. Ai fillon të ndihet i huaj, i krijohet një boshllëk që nuk e mbush dot asgjë. Me ndryshimin e kushteve jetësore dhe mbarimin e përndjekjes, ai mund ta rifillojë jetën, por kjo nuk është më e mundur.

Autori paraqet shumë fakte si parathënie, por vetëm kur i shkon në fund romanit kupton se sa të vërteta bëhen ato. Lufta kundër tyre është si luftë ndaj perëndive në antikitet, fundi dihet. Që në fillim parashtrihen të dhënat : "- Ti Azis, keq e ke me atë bile! Jo që s'do bëhesh ndonjëherë

**Periudhën diktatoriale që sundohej nga përbashkësia dhe miti i individit dhe ajo postdiktatoriale që përveç rrëmujës, zbrazjes së fshatrave, derdhjes masive të shqiptarëve përtej kufirit, solli edhe shumë "liri" që u keqtrajtua nga shqiptarët**

komandant, por kam frikë se do mbetesh pa martuar fare!", apo : Vajzën më të bukur, e merrte për nuse mashkulli me palloshin më të madh. Gjithçka i nënshtrohet fatit. Asgjë nuk e ndryshon dot atë. Pritet vetëm ndonjë magji që nuk ndodh kurrë. Edhe pse përmenden disa besëtytni, asnjë nga personazhet nuk bëhet pre i tyre. Ato shërbejnë si makina lëvizëse të fatit.

Dashuria dhe harku i triumfit Në pamje të parë duket një roman për dashurinë që nuk mbaron, për atë të përjetshmen që zë fill që nga fëmijëria, me fqinjen e bukur, që u bë shoqja e bankës dhe më pas e fejuara. Përballë saj shfaqen kundërshtitë në të cilat më e forta është "njolla" në biografi që mbeti e pakalueshme, që e prishi ekuilibrin që nuk u kthye më me gjithë përpjekjet për ta ringjallur dashurinë e vjetër.

Autori i jep shumë mundësi heroit të vet që të ngrihet pas çdo rrëzimi që ka pësuar nga goditjet e jetës. Ai përpiqet që ta ndajë nga e shkuara dhe ta nxisë drejt horizonteve të reja. Duket e vështirë po jo e pamundur. Ai lufton me fatin e keq, por çdo shteg i ri që gjen nuk e çon veçse në humnerë nga e cila duhet të ringrihet.

Triumfon në shkollën e lartë duke u bërë që në vit të parë drejtues i gazetës dhe bashkohet me të dashurën e vet. Po sa më lart të ngjitesh, aq më shumë vritesh, -thotë populli. Një njollë e shfaqur papritur në biografi e kthen në një kooperativist të rëndomtë. Edhe aty mundohet të ringrihet duke u mbajtur pas një kënge himn që thur për partinë, por vetëm pak, shpejt gremiset dhe përfundon në brigadën e plehut. Edhe në planin sentimental ndodhin po këto ngritje-ulje. Autori ia jep forcën për të vazhduar derisa ndodh momenti tragjik, vrasja, e cila ua vë kapakun të gjithave. Aty libri përfundon duke të lënë përshtypjen e fatalitetit.

Ai e shoqëron heroinë e vet deri në skutat më të fshehta e të thella të shpirtit duke e bërë të denjë si hero, si shembull që





duhet ndjekur. Përshkrimet e shumta të botës së tij, reagimet e qëndrimet, forca më të cilën dashuron apo lufton për të fituar, u ngjan heronjve të përrallave që duken të pamposhtur. Forca më e madhe lëvizëse është dashuria. Një dashuri që fiton gjithmonë. Si forcë shtytëse në vepër janë edhe të vërtetat e zbuluara papritur apo që dihen si parathënie, po nuk u kushtohet rëndësi. Ato injorohen, por janë shumë kokëforta dhe bëhen të pashmangshme në fatin e tij.

Krijimi i mjedisve të reja jetësore i jep mundësi heroit që të fillojë një jetë të re, po fati nuk i buzëqesh dot këtij njeriu që shoqërohet nga ndjenja e fatalitetit. Krahët e djegur të dashurisë nuk mund të fluturojnë. Ato jetojnë, sepse nuk mund të vdesin. Zgjimi

i saj mund t'i ripërtërijë. Por të gjitha përpjekjet u dukën të kota.

Azis Korbi ndihet i përjash-tuar si në atdheun e tij kur e bënë armik, kur mbeti vetëm pa të fejuarën e tij, duke e parë atë të martohej me një tjetër, ashtu edhe në Greqi ku ishte një emigrant. Përjashtimi e bën atë të pafuqishëm për të luftuar për realizimin e shpresave në jetën e tij. Ndaj ai ndihet i huaj në këtë botë. Edhe pse ka shumë vullnet dhe nuk dorëzohet para vështirësive ai mbetet një njeri me kohë të djegur. Të qenit i huaj nuk i lind atij ndjenjën e urrejtjes e të hakmar-rjes. Ai këmbëngul deri në fund për realizimin e ëndrrës së tij, por nuk hakmerret ndaj kundërshtarit edhe kur i ka të gjitha arsytet. Gjithë hakmarria e tij shkon me një tregim në gazetë dhe ca

► NË FOTO  
(djathtas) kopertina  
e librit "Kohë e djegur"  
(poshtë) Thanas Medi



grushta Katarsisi në letërsi vazhdon të jetojë ende. Po si mund të jetë një shpirt poetik që mundohet të sfidojë fatin e parathënë? Ai i pranon të gjitha humbjet përveç dashurisë. Sa më shumë e zbulon Azis Korbin aq më shumë bindesh për mirësinë e tij, i jep të drejtë për dëshirat që ushqen, kërkon që ato të plotësohen, pret që të hakmerret rëndshëm ndaj kundërshtarit të tij Pavllo Xhorrit.

"E më bënë të ditur për herë të parë, rreshtimin tonë në dy krahe të kundërt. Ai njeriu i shtetit, unë armiku. Ai biri i denjë i vendit, unë bastardi. Ngordhësira, i papërfillshmi i tij. I tepërti. E kaluara më shtoi në trup etheet e shpagimit. M'u duk pak një tregim në gazetë, për të cilën i kundërti im nuk e ruante fare. Shumë pak. Duhej diçka më vrastare."

Skeleti i veprës, shqetësimi Mbi gjithë veprën vërshon një shqetësim i brendshëm që lufton pareshtur me fatin e keq:

1. Shqetësimi për fatin e njeriut në diktaturë, që i priten ëndrrat në mes, për "faje" që nuk ka përgjegjësi, por që e përndjekin ashtu si te heronjtë e tragjediëve antike me konflikte në dukje më të zbehta, po me fund të njëjtë. Ky fat duket qartë në fjalët e Pavllo Xhorrit, punonjës i sigurimit në diktaturë: "Flaka t'i dalë këtij vendi, ty nuk ka ç'të duhet. Bëj sehir dhe fërko duart!"

2. Shqetësimi për fatin e një emigranti shqiptar që largohet nga vendi i tij, jo se aty nuk mund t'ia dalë, por se shpreson se në dhe të huaj do të fitojë më shumë, pavarësisht se atje gjen një mjedis armiqësor që është

gati ta sakrifikojë, vetëm për ta bërë shembull për të tjerët. Kjo përfaqësohet në vepër nga grupi "Djemtë e mbarë" që vepronin në Elinohor, në fshatin ku u vendos Azis Korbi në Greqi. Ata nuk lejonin këmbë të huaji në fshat.

3. Shqetësimi për fatin e individit në të ashtuquajturën demokraci, ku vendoset përballë shanseve jo të barabarta, që bëhet pre e të mëdhenjve që janë bërë të tillë në mënyrë të padrejtë dhe nuk u lejojnë të ngrejë kokën e të shfaqin veten duke ua prerë të gjitha rrugët. Përfaqësimi në vepër bëhet nga Pavllo Xhorri i cili vazhdon të mbetet në fuqi edhe pasi u ndërruan sistemet.

4. Shqetësim për fatin e një brezi të tërë që kërkon të shkollohet për tri ditë duke u gdhirë i

diplomuar papritur dhe duke tundur diplomën si shenjë e dijës së tyre, pa pasur frikë nga injoranca që i sundon. Që nuk hoqa dorë nga diploma e blerë, tregonte se isha prekur dhe unë nga flama e përgjithshme. Nga ajo që pillte batakçinj.

Ndërtimi dhe gjuha e përdorur nga ana kompozicionale romani në pjesën më të madhe të tij ndërtohet në dy linja paralele, një ngjarje që ndodh në momentin e rrëfimit dhe një tjetër që tregohet në retrospektivë. Janë dy dashuri që përpiqen të mbijetojnë në zemrën e Azis Korbit, njëra që është bërë pjesë e trupit të tij, një dashuri e madhe që jeton bashkë me të dhe dashuria me shikim të parë me një greke që guxoi të hedhë sytë mbi një emigrant, por duke njohur mjedisin përreth

tyre nuk pranon të dorëzohet te shqiptari edhe pse tundimi është i madh. Kjo lloj dashurie zhduket pa lënë gjurmë kur ai kthehet në atdhe, pasi e kanë ndëshkuar edhe atje. Duket që heroi nuk gjen paqe edhe pse mundohet të integrohet, ashtu si pjesa më e madhe e emigrantëve në Greqi. Paragjykimet ndaj shqiptarëve të shprehura edhe te "Hija e mallkuar" (roman tjetër i autorit), përforcohen edhe në këtë roman. Mendoj se largimi për në Greqi përdoret si një mënyrë për t'u larguar nga ngjarjet në Shqipëri që lidhen kryesisht me dashurinë e humbur. Pa dashuri nuk ka jetë, thekson autori, -duke i dhënë një mundësi tjetër, një dashuri tjetër.

Është për t'u adhuruar gjuha e përdorur. Mendoj se autori do të krijojë një fjalor me veprat e tij, ato janë të pasura me fjalë të vjetra që ai tenton t'i refuzë në përdorim duke dhënë edhe shpjegimin e tyre. Gjithashtu ai ka projektuar një stil të vetin që po bëhet përherë e më i dallueshëm. Kjo lidhet jo vetëm me trajtimin e subjekteve tërheqës, sepse një vepër nuk e bën ngjarja, por mënyra si tregohet ajo. Medi është një rrëfimtari që flet me një gjuhë të dashur për lexuesin, e ngarkuar me figuracion që herëherë në trajtimin e skenave të ngarkuara emocionale i ngjan prozave të ëmbla poetike, madje edhe poezive kur ato shkruhen në rreshta të veçantë si vargje.

Gjithë gjethëria e Lepushetit vesonte përgjumshëm.

Kullonin çatitë.

Këndonte gushkuqi.

Përkundej përmallshëm maja e barit.

Një vetull mjegulle rrinte si vello nuseje mbi majë të malit...

Përdorimi i fjalive të shkurtra përbën universin e rrëfimit. Jo vetëm i jep intesitet mendimit, por e shkrin atë në pak fjalë duke nënkuptuar shumë të tjera. Përshkrimet e personazheve janë të plota dhe të sjellin një imazh të qartë të tyre si psh. përshkrimi i vajzave greke, me njërin nga të cilat u dashuria Azis Korbi në Greqi, por që mbeti një mollë e ndaluar për të: "vajzat e Elinohorit domethënë, e kishin trupin selvi, belin unazë, hundën qiri, vetullën shushunjë dhe flokët ujvarë. Dehej era kur u prekte buzën dhe u dukej uji në gushë. Të verbonin me sy e të vrisnin me gjinj...", por në kundërshti me gjithë këto i tingëltonin me forcë fjalët e shokut të tij: varu teneqen! Duhet të ishte një punëtor kokulur, pa ëndrra, pa zemër, pa dashuri...

Konkretësia, gjuha e zgjedhur e ngritur poetikisht, nuancat e gjuhës së folur, individualizimi i personazheve, ngjyra dhe forca e përshkrimeve, i japin romaneve të Medit një tisi klasik të realizmit magjik, që po fryn si një erë edhe në letërsinë shqipe.

Agron Tufa do të shprehet për këtë roman: "kam bindjen se është një ndër penat më të plota, mjeshtërore në stil, konceptim, gjuhë e kompozicion... Më ngjit realizmi (i ri) i Medit, poetika autentike e njeriut në situata ekzistenciale...", pastaj grotesku, disfatizmi dhe këmbëngulja e personazheve të tij... Proza e sotme bashkëkohore shqipe po lëviz, po merr vrull me lëndën e vet djegëse-me brengat, makthet, pengjet e shpresat e veta. Thanas Medi, jam i bindur se është në ballë të kësaj letërsie me veçanësinë e vet"

NGJARJA | E PANJOHUR

NGA MARK BRUNGA

Në janar të vitit 1945, dy politikanë shqiptarë, ndonëse të internuar nga aleatët në një kamp transit në Bari, i mirënjohuri Mid'hat Frashëri, që ishte kreu i Ballit Kombëtar dhe një klerik nga Shkodra, Sali Muftija, ky i dyti, në emër të organizatës "Legaliteti", i kanë kërkuar Sekretarit amerikan të Shtetit në detyrë, të mos ndërmerret asnjë nismë për njohjen e qeverisë komuniste, të krijuar që para çlirimit të vendit. Ky dokument bëhet i njohur në vitet 2000. Gjithsesi, ngjall kërshëri historike. Nëse vetë, personalisht, Mid'hat Frashëri (1880-1949) mund të bënte politikë të pavarur, kjo nuk mund të thuhet për një legalist, ndonëse me merita, si Sali Muftija (1891-1978). Në komitetin drejtues të Legalitetit bënin pjesë personalitete të spikatura politike, intelektuale e kombëtare si Xhemal Naibi, Ndoc Çoba, Gaço Goga, Rauf Fico, Pater Lekë Luli O.F.M., Osman Myderrizi, etj. Personaliteti kryesor në atë periudhë është Abaz Kupi (1892-1976), komandanti i formacioneve luftarake legaliste që u organizuan në të gjithë vendin.

ARSYET

Së pari, kryetari i Lëvizjes (në dokumentin anglisht: "organization") së Legalitetit ishte Abaz Kupi. Së dyti, të tilla veprime të karakterit diplomatik, koordinoheshin nga vetë Mbreti Zog I (1895-1961). Ai më parë kishte komunikuar me letra me Presidentin Ruzvelt dhe nuk mund ta ulte "stekën" deri në nivelin e një të ngarkuari me detyrën e sekretarit të shtetit ad hoc, sikurse ishte Xhozef Grju (Joseph Grew, 1880-1965). Së treti, për shkak të kontradiktave të mëdha mes Ballit Kombëtar dhe Legalitetit, Muftija nuk kishte tagrin të bashkonte Legalitetin me vullnetin e tij në një "dumvirat" të emër të organizatës, ku aderonte. Madje, katër vjet e gjysmë më vonë, Mbreti Zog I ka kundërshtuar krijimin e komitetit "Shqipëria e Lirë", ku në krye të tij ishte vetë shefi i Legalitetit, Bazi i Canës. Ndoshta është ndonjë intrigë e vogël e Midhatit. Kuptohet, konciziteti dhe stili elegant i letrës është meritë e shkrimtarit, publicistit, politikanit të hollë dhe diplomatit Midhat Frashëri, i cili rreth 20 vjet para kësaj letrë ka qenë ambasador i Shqipërisë në Uashington. Madje dhe në "toskëzimin" e emrit nga Sali Myftija në Sali Muftija mund të ketë dorë Frashëri!

DORA E FORIN OFISIT

Por nuk përjashtohet se kjo letër dhe kjo "federatë" dy organizatash apo bashkim forcash antikomuniste mund të jetë sugjeruar nga britanikët, për të bindur akoma më shumë Uashingtonin në nevojën e një politike të shtrënguar ndaj sundimtarëve të rinj të Tiranës. Fakti që letra është dërguar si aerogram (shkresë zyrtare e çuar me postë ajrore diplomatike), pavarësisht se në



► Një partizan shqiptar mes një grupi të Marinës Mbretërore Britanike në vitin 1943, në Spille



# Si u krijua "Dumvirat" - i Ball-Legalitetit pa dijeninë e Zogut

**1945 - Intriga angleze, si u shmang mbreti Zog në mërgim nga tratativat me Uashingtonin, Londrën dhe Moskën. Letra sekrete e Mehdi Frashërit në emër të Ballit Kombëtar dhe të një figure minore në emër të Legalitetit drejtuar Sekretarit amerikan të Shtetit për mosnjohjen e qeverisë komuniste të Enver Hoxhës....**



► Mithat Frashëri (i pari majtas) me udhëheqës të tjerë të Ballit Kombëtar në Berat, tetor 1944

zyrën e pritësit ka mbërritur me 12 ditë vonesë, mund të argumentojë hamendjen se prapa Frashërit dhe Myftisë qëndronte Forin Ofisi. Të ndodhur në kamp internimi, As Frashëri as Muftija nuk mund të dinin për "izolimimin i Shqipërisë si dhe mungesën e komunikimit me botën jashtë" apo fakti "që grupe të mëdha njerëzish po rezistojnë dhe po luftojnë kundër imponimit arbitrar të regjimit komunist në vendin tonë. Rezistenca kundër strukturës së sotme në Shqipëri është edhe pasive dhe aktive". Është e natyrshme që t'i luteshin "qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës që, derisa të sqarohet me themel situata, nuk duhen ndërmarrë hapa në drejtim të njohjes së regjimit aktual terrorist në Shqipëri - një njohje që do të ishte në dëm të vendit tonë, ku përvojave të hidhura ekzistuese po u shtohen të tjera tashmë". Por ata vënë në dijeni Uashingtonin se "telegrame të ngjashme po u dërgohen edhe Shkëlqesive tyre, ministrave të Jashtëm të Britanisë së Madhe dhe të Bashkimit Sovjetik". Nëse shan dhe kërkon të mos njihet qeveria e terrorit komunist, është e dyshimtë, të paktën për

Frashërin, t'ia kërkojë këtë Moskës dhe Molotovit! Londra dhe Uashingtoni po.

KUSHTET

Në katër dokumentet e tjera, vërehet padurimi i "Luanit" britanik për të ndërmarrë një sërë kushtesh që i duheshin vënë liderit komunist për përfitimin e ndihmave dhe për pasojë njohjen e qeverisë së tij. Del se Enver Hoxha (1908-1985) ka kundërshtuar dhënien e ndihmave nëpërmjet shtimit të vëzhguesve anglo-amerikanë. Në një telegram të këshilltarit politik amerikan pranë Shtabit të Forcave Aleate në Kazerta të Italisë, drejtuar Sekretarit të Shtetit më 16 janar 1945, pohohet se "Hoxha i ka nxjerrë pengesa planit të ML-së (Military Liaison (Albania), një institucion ushtarak britanik-amerikan i ngarkuar me planifikimin dhe administrimin e ndihmave civile në Shqipërinë e çliuar) dhe nuk ka pranuar ndihma mbi çfarëdo baze tjetër përveç pranimin të furnizimeve nga bordi i anijes me minimum vëzhguesish. Përfaqësuesit e ML-së do të qëndrojnë në Tiranë disa ditë më shumë me shpresë se këshilltarët e matur të Hoxhës



► Udhëheqësi i Ballit Kombëtar, Mid'hat Frashëri, duke folur në BBC për shqiptarët e diasporës

mund zbrapsin vendimin e tij të tanishëm të pandryshueshëm. Ka pak shpresë për këtë.

#### MAKMILANI

Por këtu ka një ko incidencë historike. Ministri britanik rezident në Shtabin e Forcave Aleate të Mesdheut dhe President në detyrë i Komisionit Aleat, Itali ishte deputeti, Sër Herold Mekmillën (Harold Macmillan, 1894-1986), më vonë ministër dhe dy herë Kryeministër. Në një debat të nxehët, në vitin 1960, mes diktatorit shqiptar Enver Hoxha dhe shefit të Kremlinit Nikita Hrushovit, ky i fundit ka akuzuar se me ton të tillë ukrainasi nuk kishte guxuar t'i fliste as kryeministri anglez Makmilan, gjë që çoi në ndërprejen e bisedimeve. Pikërisht, ky lord i cituar nga homologu i tij amerikan Kërk, i ka kërkuar Londrës të ishte e matur: "Macmillan tha mbrëmë se i kishte rekomanduar Forin Ofisit se Hoxhës nuk duhej t'i bëhej trysni për çështjen e ndihmave ose për çfardo çështje për momentin, se do të ishte e parapëlqyeshme të pritët derisa të bëhen disa marrëveshje me Titon për ndihmat humanitare... dhe se Hoxha do të merrte sinjal nga Titoja".

#### ANGLO-AMERIKANËT: ENVERI TË "PUTHET" ME TITON

Pas 10 ditësh, në një telegram i Sekretarit të Shtetit në detyrë drejtuar Kërk-ut, më 26 janar 1945, thuhet se "Departamenti është dakord me pikëpamjen e Mekmillënit ndonëse mendojmë se Hoxhës i duhet bërë e qartë se jemi gati dhe kemi vullnetin të japim ndihma në çdo kohë nëse ai do të bjerë dakord për një numër të arsyeshëm vëzhguesish. Ka gjasa që konkludimi i kënaqshëm i negociatave me jugosllavët do të ndikonte në vendimin e tij". Në të tre dokumentet që po botohen këtë numër, përmendet emri i Titos (1892-1980), që duhej të "urdhëronte" Enver Hoxhën për vijën e sjelljes me britanikët dhe amerikanët. Duhet pranuar që jo vetëm Beogradi dhe Moskë, por edhe Londra dhe Uashingtoni ne heshtje, kishin vendosur që Shqipërinë t'ia linin Jugosllavisë.

#### DOKUMENTI 1

Enver Hoxha, pengesa planit të ndihmave

Telegram i z. Aleksandër K. Kërk, këshilltar politik pranë Shtabit të Forcave Aleate, drejtuar Sekretarit të Shtetit

Kazerta, më 16 janar 1945, ora 22:00 [marrë më 17 janar 14:37]

Hoxha i ka nxjerrë pengesa planit të ML-së [1] dhe nuk ka pranuar ndihma mbi çfarëdo baze tjetër përveç pranimit të furnizimeve nga bordi i anijes me minimum vëzhguesish. Përfaqësuesit e ML-së do të qëndrojnë në Tiranë disa ditë më shumë me shpresë se këshilltarët e matur të Hoxhës mund zbrapsin vendimin e tij të tanishëm të pandryshueshëm. Ka pak shpresë për këtë. Mekmillën-i (Macmillan) [2] tha mbrëmë se i kishte rekomanduar Forin Ofisit se Hoxhës nuk duhej t'i bëhej trysni për çështjen e ndihmave ose për çfardo çështje për momentin, se do të ishte e parapëlqyeshme të pritët derisa të bëhen disa marrëveshje me Titon [3] për ndihmat humanitare (shih telin tim nr. 72, datë 8 janar, mesnatë) dhe se Hoxha do të merrte sinjal nga Titoja. Mekmillëni gjithashtu tha se kishte informuar Forin Ofisin se nuk e shihte të bazuar nxitjen e ndihmave humanitare të shqiptarët si furnizime të tilla që mund të përdoren për avantazh të dobishëm, dhe se do të ishte mirë që të mos tregohet ndonjë interes i veçantë rreth marrjes së ndihmave në Shqipëri, pasi se shpejti, herët a vonë Hoxha do të vinte vërdallë.

Nga ana tjetër shqiptarët, shumë prej të cilëve kanë vuajtur së tepërmi gjatë debimit të gjermanëve nga vendi i tyre, nuk do të marrin asnjë ndihmë. Departamenti i Shtetit i Shtetit është, natyrisht, i informuar se një anije e vogël ndihmash është dërguar kohët e fundit në Split të Jugosllavisë mbi një bazë ad hoc (shih telin tim nr. 83, datë 9 janar).

Do të vlerësoja komentet e Departamentit të Shtetit.

KIRK

Shënime të origjinalit anglisht [1] Military Liaison (Albania), një institucion ushtarak britanik-amerikan i ngarkuar me planifikimin dhe administrimin e ndihmave civile në Shqipërinë e çliruar.

[2] Herold Mekmillën (Harold Macmillan), deputet, ministri britanik rezident në Shtabin e Forcave Aleate të Mesdheut dhe President në detyrë i Komisionit Aleat, Itali.

[3] Mareshal Tito (Josip Broz), Kryeministri dhe Ministri i Mbrojtjes Kombëtare në Qeverinë e Përkohshme të Jugosllavisë.

#### DOKUMENTI NR. 2

Lëvizjet e tjera që luftuan kundër pushtuesit

Aerogram i z. Aleksandër K. Kërk, këshilltar politik pranë Shtabit të Forcave Aleate, drejtuar Sekretarit të Shtetit

Kazerta, më 19 janar 1945, ora 10:00

[Marrë më 31 janar ora 18:00]

Letra e mëposhtme e nënshkruar nga Mid'hat Frashëri [1] dhe Sali Muftija iu dërgua Sekretarit të Shtetit, duke i kërkuar kësaj qeverie të mos ndërmarrë asnjë masë për njohjen e qeverisë ekzistuese të Shqipërisë:

"Kemi mësuar se Enver Hoxha, kryetar i së vetëquajturës qeveri shqiptare në Tiranë, ka kërkuar njohje zyrtare nga ana e aleatëve. Qeveritë e tre vendeve të Demokracive të mëdha kanë

## Kush është Kush? Midhat Abdyl Frashëri

(1880-1949), diplomat, shkrimtar dhe politikan. Ishte i biri i Abdyl Frashëri. Mori pjesë në Kongresin e Manastirit në vitin 1908. Një nga nënshkruesit e shpalljes së pavarësisë, ministër në Qeverinë Ismail Qemalit. Më 25 nëntor 1920, kryetar i delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris. Më pas mbajti poste të tjera ministrore dhe u caktua ambasador në Greqi dhe SHBA në vitet 1922-1926. Në vitin 1925, hapi një librari në Tiranë. Në vitin 1939, pas pushtimit të vendit vendos të rikthehet në politikë. Në vitin 1941, ideologu kryesor dhe një nga themeluesit e Ballit Kombëtar. Kundërshtar i PKSH, u detyrua në nëntor 1944, të largohet nga Shqipëria dhe të vendoset në Itali. Krijon në gusht 1949 Komitetin Shqipëria e Lirë. Më 3 tetor 1949, vdes si pasojë e një ataku kardial në hotel në Nju Jork. Ka botuar disa libra: "Naim bej Frashëri, kujtimi mbi të ungjin", "Hi dhe shpuzë", "Plagët tona" etj.

66

## Kush është Kush? Salih Efendi Myftia

Salih Efendi Myftia (1891-1978) ka qenë klerik dhe legalist shkodoran. Rrjedh nga një familje shumë e njohur besimtarësh, dijetarësh, atdhetarësh. Ka shërbyer si imam në Shkodër, ishte edhe myderriz. Në vitin 1927 myfti në Krujë, më vonë kryemyfti i prefekturës së Shkodrës dhe Kosovës. Jo vetëm që nuk u pajtua me pushtimin e Shqipërisë nga fashizmi dhe nazizmi, por iu kundërvu me armë në radhët e Lëvizjes së Legalitetit, derisa u internua në Gjirokastër. Në nëntor 1944 u arratis. Për 34 vjet, deri sa ndërroi jetë, luftoi kundër komunizmit në mërgim. Në Amerikë u vendos në Nju Jork. Më 16 maj 1966, në "Sheraton Atlantic Hotel", nën udhëheqjen e e tij, u mbajt mbledhja e Kuvendit të Qendrës Islamike Shqiptare-Amerikane. Me 12 nëntor 1972, preu shiritin e xhamisë në Bruklin, ku ishin tubuar qindra besimtarë shqiptarë, disa prej tyre të veshur me kostume kombëtare. Vdes më 19 maj 1978, në moshën 87-vjeçare.

deklaruar solemnisht se nuk do të lejojnë kursesi që një palë të imponojë vullnetin e vet me atë të forcës mbi të gjitha palët dhe mbi popullin në tërësi lidhur me

çështjen e regjimit.

Sot, nëse çështja do të shtrohej në frymë objektive, është e qartë se në Shqipëri regjimi i Enver Hoxhës, i cili është komunist, iu imponua popullit, jo vetëm me forcë, por edhe me terrorizëm të dukshëm. LNÇ-ja [2] nuk ka qenë i vetmi front i rezistencës në Shqipëri, por ka pasur dhe lëvizje të tjera që kanë luftuar kundër pushtuesit. Prandaj FNÇ-ja nuk është përfaqësuese e vullnetit të lirë të popullit shqiptar dhe nuk duhet konsideruar si e tillë.

Karakter i komunist i administratës së Enver Hoxhës është manifestuar sheshit nga deklaratat zyrtare dhe botimet e bëra nga sunduesit e sotëm që pretendojnë të jenë mbrojtës të popullit. Izolimi i Shqipërisë si dhe mungesa e komunikimit me botën jashtë e bënë të pamundur njohjen e vullnetit real të njerëzve, por është fakt që grupe të mëdha njerëzish po rezistojnë dhe po luftojnë kundër imponimit arbitrar të regjimit komunist në vendin tonë. Rezistenca kundër strukturës së sotme në Shqipëri është edhe pasive dhe aktive.

Duke marrë parasysh të gjitha këto, ne nuk mund të besojmë se qeveritë aleate do të tolerojnë në Shqipëri dominimin e një partie të vetme, e cila është plotësisht jodemokratike. Ne, prandaj, i lutemi qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës që, derisa të sqarohet me themel situata, nuk duhen ndërmarrë hapa në drejtim të njohjes së regjimit aktual terrorist në Shqipëri - një njohje që do të ishte në dëm të vendit tonë, ku përvojave të dhura ekzistuese po u shtohen të tjera tashmë.

Telegrame të ngjashme po u dërgohen edhe Shkëlqesive tyre, ministrave të Jashtëm të Britanisë së Madhe dhe të Bashkimit Sovjetik.

Me respekt,  
Për Ballin Kombëtar:  
Midhat Frashëri  
Për organizatën e "Legalitetit":  
Sali Muftija  
Më 7 janar 1945."

Aktualisht të dy nënshkruesit janë të internuar në kampin transit nr. 1, Bari, ata kanë mbërritur në Itali në nëntor (Sh. telin tim nr. 1530 datë 28 nëntor 1944 [3]).

KIRK

Shënime të origjinalit anglisht:

[1] Kryetari i Ballit Kombëtar, lëvizje e rezistencës shqiptare e cila u shpërbë në vitin 1944 gjatë luftës civile me Lëvizjen Nacional Çlirimtare e dominuar nga komunistët. Frashëri u arratis në Itali në nëntor 1944, ku ishte i internuar.

[2] Lëvizja Nacional-Çlirimtare.

[3] Nuk është botuar, njëfonte ardhjen në Bari të 150 refugjatëve politikë shqiptarë.

#### DOKUMENTI NR. 3

Marrëveshje me Enverin si me Titon

Telegram i z. Aleksandër K. Kërk, këshilltar politik amerikan pranë Shtabit të Forcave Aleate, drejtuar Sekretarit të Shtetit

Kazerta, më 26 Jan 1945, ora 24:00

[Marrë më 9 shkurt, ora 24:00]

315. Teli im nr. 176, datë 16 janar, ora 22:00. Si rezultat i rugës pa krye ku janë futur ndihmat humanitare për Shqipërinë u vendos në një takim dje në AFHQ [1] që gjeneral Sadler [2] duhet t'u kërkojë Shefave të Përbashkët të Shtabit modifikimin e direktivës ekzistuese (Fan 428 [3]), në mënyrë që të lejoje negociimin e një marrëveshjeje ushtarake midis përfaqësuesit të SACMED-it [4] dhe Hoxhës si

a jo kohët e fundit me Titon. [5] Besohet se Hoxha së shpejti do të afrohet me M / L-në dhe se mund të arrihet një marrëveshje me anë të së cilës ai mund të pranojë një numër fillestar prej afër 200 vetash të të gjitha niveleve në vend të 1200 të parashikuar në krye të herës. Tashmë është hequr dorë nga përpjekjet për të futur ndihma në baza ad hoc dhe se nuk është pranuar alternativa tjetër, pra shpërbërja e M / L. [6]

Negocimi i një marrëveshjeje ushtarake me Hoxhën sigurisht një faktin që Hoxha dhe FNÇ-ja kontrollojnë në mënyrë efektive Shqipërinë aktualisht. Do të ishte e dëshirueshme po të më informonte departamenti urgjentisht nëse ky propozim ka miratimin e tij. [7]

#### KËRK (KIRK)

Shënime të origjinalit anglisht

[1] Inicialet për "Allied Force Headquarters" (Shtabi i Forcave Aleate).

[2] Gjeneral Brigade Persi L. Sejdler (Percy L. Sadler), ushtria amerikane, zëvendës-komandant për operacionet e përbashkëta me britanikët për ndihmë dhe rehabilitim në vendet e Ballkanit.

[3] Mesazhi i datës 23 shtator 1944, nga Shefat e Përbashkët të Shtabit pranë Komandantit Suprem Aleat i Mesdheut, që e autorizonte të hynte në ujdi me grupe të tilla vendore që kishin nën kontroll Shqipërinë, në mungesë të një qeverie që nuk ishte njohur ende ndërkombëtarisht. Megjithëse i autorizuar të bënte diskutime me këto grupe, ishte porositur të mos bënte asnjë premtim të prerë për ndihmë. Pjesa përkatëse e Fan 428, është përmbledhur në telegramin nr. 202, datë 2 tetor 1944, në Kazerta.

[4] Inicialet për "Supreme Allied Commander, Mediterranean Theater" (Komandanti Suprem Aleat i Mesdheut), feld-mareshalin Sër Herold Aleksandër (Sir Harold Alexander).

[5] Për një përshkrim të shkurtër të marrëveshjes së 19 janarit 1945, midis autoriteteve jugosllave dhe SACMED-it lidhur me ndihmat e ML-së në Jugosllavi, shih: George Woodbridge, "UNRRA: The History of the United Nations Relief and Rehabilitation Administration" (New York, Columbia University Press, 1950), vol. II, pp. 141-142.

[6] Më 11 prill 1945, u nënshkrua një marrëveshje për futjen dhe shpërndarjen e ndihmave humanitare në Shqipëri nga Military Liaison (Albania) midis Komandantit Suprem Aleat të Mesdheut dhe gjeneral-kolonelit Hoxha. Kontrata e ML-së skadonte më 23 qershor 1945, dhe nuk u përtëri. Operacionet e ndihmave të ML-së përfunduan më 30 qershor dhe stafi i ML-së u largua nga Shqipëria më 5 korrik. Për periudhën 18 prill - 5 korrik, ML (Albania) dorëzoi 9.150 tonë furnizime, 334 kamionë, 9 ambulanca dhe 24 traktorë për bujqësinë.

[7] Në telegram nr. 78, datë 30 janar, ora 19:00, drejtuar Kazertës, thuhet në veçanti, si më poshtë: "Me sa duket nuk do të ketë asnjë kundërshtim për nënshkrimin e një marrëveshjeje ushtarake me Hoxhën të ngjashme me marrëveshjen e fundit me Titon sipas skemës së përshkruar në telegramin tim nr. 315, datë 26 janar. Një marrëveshje e tillë sigurisht do të jetë në një nivel thjesht ushtarak dhe e formuluar në mënyrë që të mos ketë njohje të autoriteteve ekzistuese sikurse linte të nënkuptohej qeveria e Shqipërisë".



Lojtarët e Kukësit duke festuar

# Falë Pejic Kukësi mund Laçin dhe kap sërish kreun

## Verilindorët i përgjigjen Partizanit duke fituar 2-1. Vllaznia barazim me Korabin

**K**ukësi i kundërpërgjigjet Partizanit pasi falë fitores 2-1 ndaj Laçit rimer kreun të klasifikimit dhe shkon në sfidën direkte të javës së ardhshme me objektivin për të mos u mundur. Ashtu sic pritej në fushë skuadrat dhuruan një 90 minutësh spektakolar, me lojë agresive dhe raste të shumta shënimi. Rastin e parë për shënim e kishin miqtë, pasi në minutën e 7 është Ansi Nika ai që i afrohet goli, por Enea Kolici tregon se jo më kot meriton lëvdatat e deritanishme, duke shpëtuar një gol të sigurtë. Kundërpërgjigja e Kukësit është e vakët, ku në minutën e 10 është një krosim i Kariokës që nuk shfrytëzohet nga askush në zonë. Të gjithë presin nga sulmi me dyshen Emini-Pejic, por protagonist mbetet Kolici, që në minutën e 12 shpëton portën e tij nga dy tentativa të Mensah. Barën e sulmit tek Kukësi e marin përsipër brazilianët, dhe në të 16 është Kale që nga afër godet mbi traversën. 4 minuta më vonë është Izair Emini që me një gjysmërovëshatë guan jashtë kuadratit. Laçi i beson kundërsulmit dhe në minutën e 27 është Ansi Nika që del i vetëm përballë Kolicit, por duke guan në mënyrë të gabuar duke e dërguar topin jashtë. Dyminuta më vonë është kundërpërgjigja e Kale që vjen si një fotokopje e tentativës së Nikës. Koha shtesë është e mbushur me emocione pasi Mensah në tentativë për të larguar topin me një gjysmë kthesë e prek atë me dorë, por për gjyqtarin Kridens Meta gjithçka është e rregullt. Megjithatë festa e vendasve do të vijë përpara se të shkojnë në dhomat e zhveshjes, me të zakonshmin Pero Pejic që përballë portierit Vata shënon golin e avantazhit. Nëse pjesa e parë u mbyll me festë për vendasit e dyta do të nisë me festë për miqtë. Një kuksian, një ish i kësaj sfide është ai që prish humorin në Zeqir Ymeri. Sapo nis pjesa e dytë Fjoart Jonuzi përfiton nga gabimi i Albi Allës duke rikthyer barazeshën. Të

befasuar nga ky gol Kukësi u mundua të reagojë, dhe në minutën e 48 Emini provon me një gjuajtje që përfundon jashtë. 2 minuta më pas Pero Pejic pretendon për një penallti, megjithatë festa për bomberin e kuksianëve nuk vonon. Në të 53 do të gjejë golin e dytë të ndeshjes, duke e cuar në 20 numrin e golave sezonal, por një realizim që ka vlera të jashtëzakonshme. 30 minuta përpara fundit është Laçi që pretendon për penallti, teksa Mensah pengohet në zonë nga Musolli. Ritmi i lartë nuk ka shteruar energjitë, pasi në të 65 është sërish Emini që provon me kokë por gjuajtja e tij përfundon jashtë. Laçi nuk heq dorë nga sulmi, por pavarësisht lojës së mirë dhe disa rasteve nuk ka

mundur të gjejë golin. Kështu me shumë vuajtje Kukësi merr fitoren e 17 sezonale, duke shkuar në sfidën ndaj Partizanit me moralin e duhur. Për Laçin kjo humbje komplikon situatën teksa mbijetesa bëhet gjithnjë dhe më e vështirë.

### ZHËNJEN VLLAZNIA

Korabi prish planet e Vllaznisë për Europën. Skuadra dibrane e rënë matematikisht në Kategorinë e Parë befason kuqebllutë me një barazim 1-1 në "Loro Boriçi", duke i dhënë asist Luftëtarit për vendin e katërt. Thujse gjatë gjithë pjesës së parë kuqebllutë e qarkulluan dendur topin në gjysmëfushën e Korabit, por e kishin të vështirë të gjenin hapësira për të goditur portën. Çinari rrezikoi dy herë brenda 12 minutave lojë,

por vendasit e gjetën golin me Gurishtën, që kërcëu bukur me kokë pas harkimit të Bakajt nga këndorja pa u mbyllur pjesa e parë. Befason Korabi në fillim të pjesës së dytë. Elvis Prenci i shpëton mbulimit të Tafilit në momentin e ekzekutimit të një këndoreje, dhe shënon me kokë duke nxjerrë bluf edhe portierin Selimaj. Vllaznia rrit presionin në pjesën e dytë, por nuk kishte edhe fatin me vete, pasi shtylla bëhet lojtari i 12-të për Korabin si në rastin e Pjeshkës në të 82-ën, edhe në momentin e minutës së 90-të, me protagonist Elis Bakajn. Minutat shtesë e bënë edhe më të ethshme sfidën me goditjen e Gurishtës që u ndal thujse në vijën fatale nga futbollistët e Korabit, që merr një barazim për nder në Shkodër.

## BUNDESLIGA

# Bayern Munich kampion i Gjermanisë, 3 javë para fundit

**B**ayerni i Mynihut fiton matematikisht titullin e pestë radhazi në Bundesligë dhe të 27-tin në elitën e futbollit gjerman, tri javë para përfundimit të kampionatit. Skuadra e Carlo Ancelottit shkatërroi 0-6 Wolfsburgun duke dominuar në cdo drejtim në Wolfsburg Arena. Distanca prej 10 pikësh me Leipçigun rikonfirmon kampionët në fuqi, të cilët edhe në këtë sezon nuk patën rivalë. David Alaba ekzekutoi

mjeshtërisht një goditje të lirë në minutën e 19 për golin parë të sfidës. Ndërsa në të 36-tën Lewandowski i shërbyer nga Muller e coi rezultatin në 2-0. Sulmuesi polak shënoi të dytin personal pak para se skuadrat të shkonin në dhomat e zhveshjes për pushimin mes pjesëve. Arjen Robben me një nga depërtimet e tij të zakonshme e thelloi më tej diferencën në të 66-ën. Dalja e Luis Gustavos me karton të kuq e bëri edhe më të rëndë

humbjen e Ëolfsburgut, pasi Muller dhe më pas Kimich vulosën rezultatin tenistik 0-6. Titulli i Bundesligës në fakt është i vetmi i fituar nga bavarezët në këtë sezon, pas eliminimit të tyre në Champions dhe Kupën e Gjermanisë. Borussia e Dortmundit ndalet në momentin më të mirë, pasi në shtëpi ndaj Kolnit nuk shkon më shumë sesa barazimi pa gola. Verdhëz-injtë vinin në këtë sfidë me moralin e lartë pas atij kual-



ifikimi në Kupë në shtëpinë e rivalëve të Bayern Mynih, duke kërkuar të siguronin edhe vendin e 3 në klasifikim. Pavarësisht të gjithë arsenalit të rëndë të hedhur në fushë, Borussia nuk arrin të thyejë kundërshtarin

## Në fokusin e lexuesit online

[SHQIPTARJA.com]

### LAJMET MË TË LEXUARA DJE

- Video/ Njihuni me djalin e Metës surpriza e Monikës për ditëlindje
- Sanksionet që rrezikojnë krerët e PD-së nga SHBA dhe BE
- PS po zyrtarizon kandidatët për zgjedhjet e 18 qershorit/ Lista
- Rama ulet në karrigen e Berishës, Doktorit e diagnostikon
- Regjistrimi i listave, KQZ: 'Afati skadon sot' PD: U dogj mbrëmë
- Si ta kuptoni që orizi që blini është i vërtetë apo sintetik. Ja 3 mënyrat
- Tiranë, gjendet i vdekur në banesë, lë një letër amanet
- Nuk e dini sa deputetë do të ketë qarku juaj? Mësojeni, ja lista
- Ilir Meta zgjidhet President pllakos heshitja në çadrën e PD
- Foto e parë e çiftit presidencial Monika Kryemadhi e Ilir Meta

### LAJMET MË TË KOMENTUARA

- Basha: Meta u bëre President me pazare, të të gëzojë Rama
- Regjistrimi i listave, KQZ: 'Afati skadon sot' PD: U dogj mbrëmë
- Sanksionet që rrezikojnë krerët e PD-së nga SHBA dhe BE
- Qosja: Basha furnizoi Dick Martyn me të dhëna imagjinare për krimet e UÇK
- Basha: Data 18 Qershor ka rënë as PS-LSI nuk garojnë dot

### VIDEOT MË TË KLIKUARA DJE

PD 3 skenarë për Kavajën drejt përplasjes me policinë



Momenti kur Anita Haradinaj mëson lirin e të shoqit

Meta: Iki nga LSI sot në mbrëmje nga nesër takohem me Bashën



Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të REPORT TV që shkarkohet falas

## SONDAZH I DITES

Ilir Meta si President mund të ndihmojë në zgjidhjen e ngërçit politik?

### Rezultati i Sondazhit

Po 52.30%  
Jo 43.93%  
Nuk e di 3.77%

#### SHËNIM:

Sondazhet online të Shqiptarja.com, nuk kanë vlerë statistikore. Bëhet fjalë për pyetje që u bëhen të gjithëve dhe jo kampionëve të përpunuar në mënyrë shkencore. Pra, kanë si qëllim të vetëm të lejojnë lexuesit të shprehin mendimin e tyre rreth temave të aktualitetit. Megjithatë, çdo lexues, mund të votojë vetëm një herë në ditë



1.294 | 328.524  
KOMENTET E DJESHME | TOTALI LIKE

FJALËKRYQESH

NGA KADRI VOKOPOLA

FJALËKRYQI PA SKEMË

DUHET TË NXINI 35 KUTI

17x17 crossword grid for 'Fjalëkryqi pa skemë'.

HORIZONTAL

- 1. Një që kuron lëkurën... 2. Rita këngëtare... 3. Mendës regjisor... 4. Janë figurat si metonimia... 5. Është raketë europiane... 6. Në hyrje të pistës... 7. Umberto që ka shkruar Emri i trëndafil...


PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT PA SKEMË

Word search grid for 'Fjalëkryqi pa skemë'.

- 12. Është plumb... 13. Një këngëtare... 14. Pak sorollatije... 15. Është skuadra kampione... 16. Një shtyllë me vela... 17. Ente Ekonomike Berat... 18. Ndahen në barazim... 19. Gjysmë qetësi... 20. Daja trainer... 21. Fantazisti në futbollin amerikan... 22. Mbetur në fund... 23. Civile pa çifte... 24. Gjysmë detari... 25. Vihet për të dëgjuar... 26. ... Shop Boys... 27. Një pjesë e akademisë... 28. Luhet në ekstreme... 29. Mbyllin fushat... 30. Falen pa fe... 31. Personazhi në foto... 32. Personazhi në foto... 33. Personazhi në foto... 34. Personazhi në foto... 35. Personazhi në foto... 36. Personazhi në foto... 37. Personazhi në foto... 38. Qendër në kaos... 39. Personazhi në foto...

- 5. Giorgio stilist... 6. Fillojnë trajtimin... 7. Janë stacionet e beduinëve... 8. Lëvizja e Ilir Metës... 9. Diftong kroat... 10. Mund të jenë limousine... 11. Hunt aktore... 12. Ushqen celularin... 13. Një balet i famshëm... 14. Marco, mesfushor italian... 15. E vërtetë... 16. Bie një me ballë... 17. Aleat pa çifte... 18. Kështu tregohet ai që vepron... 19. Një është Etrit Berisha... 20. Daja trainer... 21. Fantazisti në futbollin amerikan... 22. Mbetur në fund... 23. Civile pa çifte... 24. Gjysmë detari... 25. Vihet për të dëgjuar... 26. ... Shop Boys... 27. Një pjesë e akademisë... 28. Luhet në ekstreme... 29. Mbyllin fushat... 30. Falen pa fe... 31. Personazhi në foto... 32. Personazhi në foto... 33. Personazhi në foto... 34. Personazhi në foto... 35. Personazhi në foto... 36. Personazhi në foto... 37. Personazhi në foto... 38. Qendër në kaos... 39. Personazhi në foto...

FJALËKRYQI SPORTIV



PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT SPORTIV

Word search grid for 'Fjalëkryqi sportiv'.

HORIZONTAL

- 1. Seksion Sigurimi Civil... 4. Si sipër... 7. Kështu fillon sfida... 9. Alban Bushi... 11. Fitore pa fre... 12. I katërti në kapitull... 13. Ka tetë korsi... 15. Holyfield, ish-kampion i ringut... 18. Panajoti i oaharruar i futbollit... 19. Një është Etrit Berisha... 20. Daja trainer... 21. Fantazisti në futbollin amerikan... 24. Do plumb...

- 25. Vihet për të dëgjuar... 26. ... Shop Boys... 27. Një pjesë e akademisë... 28. Luhet në ekstreme... 29. Mbyllin fushat... 30. Falen pa fe... 31. Personazhi në foto... 32. Personazhi në foto... 33. Personazhi në foto... 34. Personazhi në foto... 35. Personazhi në foto... 36. Personazhi në foto... 37. Personazhi në foto... 38. Qendër në kaos... 39. Personazhi në foto...

VERTIKAL

- 1. Omar që thirrej El cabezon... 2. Një vend nisjeje... 3. Antonio trainer i Chelsea... 5. Nganjëherë nuk e vlen qiranë... 6. I katërti në kapitull... 7. Skuadra e Ferraras në Itali... 8. Fundi i... garës... 9. Të parat në atletikë... 10. Marco van... ish-bomber... 14. Pak sorollatije... 15. Është skuadra kampione... 16. Një shtyllë me vela... 17. Ente Ekonomike Berat... 18. Ndahen në barazim... 21. Gjysmë qetësi... 22. Mbetur në fund... 23. Civile pa çifte... 24. Gjysmë detari... 25. Vihet për të dëgjuar... 26. ... Shop Boys... 27. Një pjesë e akademisë... 28. Luhet në ekstreme... 29. Mbyllin fushat... 30. Falen pa fe... 31. Personazhi në foto... 32. Personazhi në foto... 33. Personazhi në foto... 34. Personazhi në foto... 35. Personazhi në foto... 36. Personazhi në foto... 37. Personazhi në foto... 38. Qendër në kaos... 39. Personazhi në foto...

SUDOKU

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo rresht e kolonë të ketë numrat nga 1-9

PËRGJIGJE

Sudoku grid with numbers.

9x9 Sudoku grid.

HOROSKOPI

DASHI

Nuk do keni asnjë lloj problemi me partnerin tuaj gjatë kësaj dite, përkundrazi do jeni me te qete dhe do flisni me te edhe për disa tema delikate...

DEMI

Gjerat ne jetën tuaj ne çift nuk priten te jene te mira sot. Ose do largoheni nga ai qe keni ne krahe, ose do keni mosmarrëveshje te ashpra dhe nuk do ndiheni asnjë çast te qete...

BINJAKËT

Jeta juaj ne çift do jete e paqëndrueshme gjate kësaj dite. Ne shume momente do keni debate te forta me partnerin edhe pse njerat do ju bien shpesh dhe do pendoheni...

GAFORRJA

Ka mundësi qe sot te përballeni me zhgënjime ju te dashuruarit. Partneri nuk do jete ne humorin e duhur dhe nuk do ua plotësojë aspak ato qe u kishte premtuar...

LUANI

Mosmarrëveshjet me partnerin tuaj ka rrezik te shtohen gjate kësaj dite. Për shume gjera nuk do merreni vesh fare dhe do bëni atë qe do mendoni me te logjikshme...

VIRGJËRESHA

Mundohuni te mos i dramatizoni gjerat sot ju te dashuruarit sepse debete te vogla kane te gjithë. Nga ana tjetër do bëni mire te toleroni pak me tepër dhe te mendoni për diçka ndryshe nga rutina e përditshme...

PESHORJA

Ka rrezik te mos i qëndroni besnike partnerit tuaj gjate kësaj dite sepse disa personajoshës do flirtojnë me ju dhe do u bëjnë te dilni nga realiteti. Beqaret do jene te hapur për gjithçka dhe mund te fillojnë edhe lidhje te menjëhershme...

AKREPI

Dialogu do mbizotërojë gjate gjithë kohës ne jetën tuaj ne çift sot kështu qe jo vetëm qe nuk do keni mosmarrëveshje, por do përjetoni edhe emocione te veçanta pranë njeri-tjetrit...

SHIGJETARI

Nëse jeni ne një lidhje mundohuni te jeni sa me realiste sot dhe te mos kërkoni për asnjë çast gjera te pamundura. Jeta nuk është telenovela kështu qe qëndroni me këmbë ne toke...

BRICJAPI

Do keni teka te shumta sot ju te dashuruarit dhe partneri për fat te keq nuk do arrijë dot t'ua plotësojë te gjitha. Kjo mund t'iu mërzitë për momentin, por kur te reflektoni ne qetësi do e kuptoni se keni gabuar ju...

UJORI

Ju te dashuruarit keni për te pasur një dite te begate dhe te mbushur me emocione te forta sot. Do merreni vesh për çdo gjë me atë qe keni ne krahe dhe bashkëpunimin tuaj do e kenë zili te gjithë. Edhe për beqaret do ndodhin gjera te bukura dhe mjaft interesante sot...

PESHQIT

Jeta juaj ne çift do konsolidohet edhe me shume gjate kësaj dite. Klima do jete ne çdo moment pasionante dhe tejet e këndshme. Beqaret nuk do lodhen shume për te gjetur personin e përshatshëm sepse miqtë do mendojnë për gjithçka deri ne detaje...

PËRGJIGJE

Word search grid for 'Fjalëkryqi i kriptografuar'.

SHKRONJA E NJËJTË PËR NUMËR TË NJËJTË

FJALËKRYQI I KRIPTOGRAFUAR

Complex crossword grid for 'Fjalëkryqi i kriptografuar'.

# NA VIZITONI



# BUNK'ART 2

EKSPOZITA VIDEO-MUZEALE BRENDIA ISH-BUNKERIT ANTI-BËRTHAMOR I MINISTRISË SË BRENDSHME

[www.bunkart.al](http://www.bunkart.al) / [info@bunkart.al](mailto:info@bunkart.al)

**HAPUR ÇDO DITË:  
10:00 deri 20:00**



**Prenotime:  
+355 (0) 67 20 72 905**

**RR. "ABDI TOPTANI"  
PRANË MINISTRISË  
SË BRENDSHME-TIRANË**

